

ANA LALAJ

SHQIPËRIA DHE INFORMBYROJA

1. Rezolucioni i Informbyrosë dhe kthesa shqiptare (qershor 1948)

Partia Komuniste Shqiptare (PKSh) nuk ka qenë anëtare e Informbyrosë¹ dhe as është ftuar ndonjëherë të marrë pjesë në mbledhjet e saj. Por megjithëse ka munguar një marrëdhënie e formalizuar midis saj dhe PKSH, kjo organizatë komuniste ndërkombëtare, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ka pasur rolin e vet të dukshëm në veprimtarinë e udhëheqjes komuniste shqiptare.

Në marrëdhëniet e Shqipërisë me Informbyronë, pika kulmore është Rezoluta e IB e vitit 1948. Siç dihet, ajo u parapri nga tri letra që udhëheqja sovjetike i drejtoi PKJ. Partitë komuniste, anëtare ose jo të IB, iu bashkuan Stalinit kundër PKJ. Midis drejtuesve komunistë, Enver Hoxha u shfaq më aktiv, çka tregonte për marrëdhëniet mjaft komplekse të PKSh me jugosllavët. Më 29 qershor 1948, PKSH e botoi në gazetën “Bashkimi”² Rezolucionin e Informbyrosë bashkë me një Komunikatë të vetën, ku e dënonte hapur qëndrimin e PKJ, si parti “tradhtarë, antimarksiste, antisovjetike”, që ishte përpjekur “për të zhdukur independencën e Shqipërisë” dhe “për ta kthyer Shqipërinë në një koloni të saj”.³ Po atë ditë, kryeministri Enver Hoxha⁴

¹ Informbyro ose Kominform, u quajt me këtë emër organi konsultativ i nëntë partive komuniste dhe punëtore të Evropës, përkatësisht të Bashkimit Sovjetik, Jugosllavisë, Bullgarisë, Polonisë, Çekoslovakisë, Hungarisë, Rumanisë, Francës dhe Italisë. Informbyroja u krijua në shtator 1947 për të shkëmbyer përvojë dhe, sipas rastit, për të koordinuar veprimet midis partive komuniste. Selia e saj fillimisht u vendos në Beograd dhe më pas në Bukuresht. U shpërnda më 1956.

² Organ qendror i Frontit Demokratik të Shqipërisë dhe atë kohë e vetmja gazetë e përditshme në vend. Pas luftës, megjithëse në pushtet erdhën komunistët, PKSh qëndroi në gjysmëilegalitet deri në vitin 1948. Gjatë kësaj kohe, materialet e saj ajo i publikonte në gazetën “Bashkimi”. Në vitin 1948 PKSh filloi ribotimin e gazetës së saj, “Zëri i popullit”.

³ Gazeta *Bashkimi*, 30 qershor 1948.

⁴ Enver Hoxha ishte në të njëjtën kohë Sekretar i Përgjithshëm i KQ PKSh, kryeministër, ministër i Jashtëm, komandant i përgjithshëm i Ushtrisë shqiptare dhe kryetar i Frontit Demokratik të Shqipërisë. Në vitin 1954 ai u lirua nga detyrat e tjera, duke mbajtur vetëm funksionin e Sekretarit të Parë të PPSH dhe të kryetarit të Frontit Demokratik.

urdhëronte të gjitha ministratë dhe institucionet e tjera të kryesore në vend të hiqnin fotografinë e Titos dhe të vendosnin vetëm fotografinë e Stalinit dhe të komandantit.⁵ Legatat shqiptare në Moskë, Beograd, Sofje dhe Paris morën porosi: “Mbroni Rezolutën e Informbyrosë. Kurdoherë që të keni nevojë për këshillime duhet të bashkëpunoni me përfaqësitë e BS”, ndërsa “kontaktet me përfaqësitë jugosllave t’i keni të kufizuara dhe të ftohta”.⁶

Më 30 qershor 1948, qeveria shqiptare i kërkoi Legatës jugosllave në Tiranë të largoheshin specialistët dhe këshilltarët jugosllavë, brenda 48 orëve si “të panevojshëm dhe të padëshirueshëm”.⁷ Një ditë më vonë, më 1 korrik, me një notë të veçantë, qeveria shqiptare “denonconte të gjitha marrëveshjet, akordet dhe protokollet duke i konsideruar ato të pavlefshme e të paqena”.⁸ Gjithashtu, më 1 korrik, Ministria e Punëve Brendshme mbylli librarinë “Libri Jugosllav”, si dhe u ndalua shitja e gazetës jugosllave “Borba”. Më 7 korrik u mblodhën të gjithë aktivet e PKSh në rrethet e vendit, ku pjesëmarrësve iu dha një material standard për Rezolucionin e Informbyrosë, në të cilin konstatohej se PKJ kërkonte të zhdukte pavarësinë e Shqipërisë, të ndante Shqipërinë nga BS dhe të nënshtronte udhëheqjen e PKSH. Më pas u bënë mbledhje të organizatave të partisë dhe organizatave të masave.

Një pyetje mund të ngrihet: Përse Shqipëria u përfshi kaq vullshëm në prishjen e marrëdhënieve me Jugosllavinë? Si është e mundur që në tri-katër ditë të hidhej në erë një miqësi disavjeçare, që ishte formalizuar në një traktatë miqësie e ndihme reciproke dhe në 28 marrëveshje, protokolle dhe akorde të bashkëpunimit reciprok dhe që ishte cilësuar si “e pavdekshme dhe me rrënjët në gjak”? Në parim duhet thënë se Shqipëria nuk bënte përjashtim nga vendet e tjera komuniste, ku propaganda ishte e sofistikuar dhe ndryshonte shumë nga realiteti. Në praktikë, marrëdhëniet shqiptare-jugosllave kishin dritëhijet e veta. Dokumentet e deklasifikuara në arkivat shqiptare kohët e fundit tregojnë se kthesa shqiptare u diktua nga interesa politike, ekonomike dhe nacionalë. Nëse udhëheqësit shqiptarë me në krye E. Hoxhën e pranuan pa kushte Rezolucionin e Informbyrosë dhe nuk nguruan të ndërmarrin një kthesë të menjëhershme, kjo erdhi:

a) nga pakënaqësitë e akumuluarat e në rritje të udhëheqjes shqiptare ndaj asaj jugosllave dhe sidomos,

⁵ Me këtë emër thirrej Enver Hoxha në vitet e para të pasluftës, për shkak të funksioneve drejtuese në ushtri gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

⁶ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), viti 1948, dos. 163.

⁷ *Po aty*, viti 1948, dos. 159.

⁸ *Po aty*, dos. 207. Sipas notës së qeverisë shqiptare të datës 1 korrik 1948, nr. 449, “qeveria jugosllave ka zbatuar në mënyrë brutale politikën e saj sundonjëse në vendin tonë, ka praktikuar një politikë ekonomike koloniale shfrytëzimi”.

b) nga përçarjet dhe konfliktet në vetë udhëheqjen politike të PKSh, që jo rrallë herë merrnin formën e dy vijave: sovjetike dhe jugosllave.

Rezolucioni i Kominformit i vitit 1948 bëri që ngjarjet të rridhnin në mënyrë të atillë, që Shqipëria nga satelit i Jugosllavisë në fillim të vitit 1948, në fund të atij viti të kthehej në satelit të BS. Efekti i Letrave të KQ PKBS dërguar KQ PKJ, për udhëheqjen e PKSh ishte tronditës. Marrëdhëniet me PKJ, për komunistët shqiptarë ishin jo vetëm një problem ndërkombëtar, por edhe një problem i madh i brendshëm. Të deleguarit e PKJ dhe të qeverisë jugosllave kishin qenë vazhdimisht të pranishëm pranë PKSh që nga krijimi i saj⁹. Qeveria jugosllave ishte e para që e njohu qeverinë shqiptare komuniste të pasluftës. Në arenën ndërkombëtare jo rrallëherë Shqipëria përfaqësohej nga diplomatët jugosllavë. U nënshkruan dy traktate mbi të cilat u mbështetën marrëveshjet, protokollat dhe akordet e tjera ndërmjet dy vendeve: më 1 korrik 1946, Traktati mbi bashkëpunimin ekonomik ndërmjet RPJ dhe RPSH, dhe më 27 nëntor 1946, Traktati mbi koordinimin e planeve ekonomike, bashkimit doganor dhe unifikimit të valutës ndërmjet RFPJ dhe RPSH, me një afat kohor prej 30 vjetësh. E. Hoxha vizitoi Jugosllavinë, më 23 qershor-2 korrik 1946, kur dhe ra dakord me drejtuesit jugosllavë për një Traktat Miqësie dhe Ndihe Reciproke, që u nënshkrua më 9 korrik në Tiranë. Erdhën në Shqipëri me qindra specialistë jugosllavë për ekonominë, ushtrinë, arsimin, kulturën etj. dhe u krijuan strukturat e përbashkëta përkatëse. Të gjitha këto veprimtari u shoqëruan me një propagandë marramendëse për vëllazërimin midis dy popujve, dy partive e dy shteteve.¹⁰ Ky status i Jugosllavisë në Shqipëri ishte plotësisht i njohur, i lejuar dhe madje i inkurajuar nga Moska.¹¹ Por në vitin 1947, kur traktatet dhe marrëveshjet ekonomike duheshin vënë në jetë, atëherë u shfaqën vështirësitë, filluan kritikata e së bashku me to dhe mosmarrëveshjet.

2. Fillimet e krizës shqiptaro-jugosllave.

Akuzat jugosllave

Në çastin kur Rezolucioni i Informbyrosë mbërriti në Tiranë, trashëgimia e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave përveç anës së saj të ndritshme dhe të

⁹ Miladin Popović, Dushan Mugosha, Velimir Stojnić, Savo Zlatić, kanë qenë të dërguar të KQ PKJ pranë KQ PKSh, që nga krijimi i PKSh e deri në ndërprerjen e marrëdhënieve ideologjike ndërmjet dy partive.

¹⁰ Gazeta *Bashkimi*, 17 prill 1945; 25 qershor, 4 korrik, 7 gusht 1946; 12 maj, 22 gusht, 4 tetor 1947 etj.

¹¹ Leonid Gibianskii, "The Soviet Bloc and the Initial Stage of the Cold War: Archival Documents on Stalin's Meeting with Communist Leaders of Yugoslavia and Bulgaria, 1946-1948", *Cold War International History Bulletin* 10, p. 120, 122. Stalini i kish thënë Titos në Moskë, në shkurt 1946 se duhet punuar që "Shqipëria dhe Jugosllavia të afrohen më shumë me njëra tjetrën".

njohur, kishte dhe anën e saj të hijezuar, që nuk publikohej dhe mbahej tabu nga udhëheqja shqiptare. Akuza të ndërsjella ndërmjet udhëheqjes komuniste shqiptare dhe asaj jugosllave kishin qenë të pranishme qysh para mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Në Plenumin e II të KQ PKSh, të mbledhur në Berat, më 23-27 nëntor 1944, për të bërë bilancin e Luftës dhe për të përcaktuar detyrat që dilnin pas çlirimit të Shqipërisë, Velimir Stojnić,¹² i deleguar i KQ PKJ pranë KQ PKSh, bëri kritika të ashpra për vijën “sektare”, “oportuniste”, “terroriste” të PKSh. Drejtues të tjerë të PKSh të asaj kohe me të cilët V. Stojnić kishte bërë takime paraprake herë për t’u informuar, herë për të nxitur ambiciet e tyre për pushtet e herë për të diktuar patronazhin jugosllav, E. Hoxhën e cilësuan bartësin kryesor të gabimeve.¹³ Pas këtyre goditjeve në plenum ndaj E. Hoxhës dhe vijës së PKSh, V. Stojnić i cilësoi J.B.Titon, udhëheqësin kryesor të Ballkanit dhe Jugosllavinë, vendin që kishte bërë luftën më të ashpër kundër fashizmit dhe që gëzonte autoritetin më të madh në Ballkan. Ai i vuri detyrë udhëheqjes komuniste shqiptare të popullarizonte Titon dhe Jugosllavinë në Shqipëri me fjalë dhe me vepra.¹⁴ Gjithsesi në këtë plenum u krijua krisja e parë e thellë në udhëheqjen e PKSh, ku nga një anë qëndronte E. Hoxha dhe mbështetësit e tij dhe nga ana tjetër N. Spiru, S. Malëshova, K. Xoxe, që orientoheshin nga jugosllavët. Pavarësisht se nuk u deklaruan fraksione të hapura, shokët e dikurshëm të luftës u pozicionuan në llogore të reja, por jo më përballë pushtuesit fashist por përballë njëri-tjetrit.

Në rrjedhë të këtyre synimeve, çdo tendencë për vetëveprim nga udhëheqësit shqiptarë bëhej shkak për akuza dhe mosmarrëveshje me këshilltarët jugosllavë. Këta të fundit disa herë e kishin akuzuar udhëheqjen komuniste shqiptare për “mungesë besimi” ndaj PKJ. Të tilla akuza arritën kulmin në korrik dhe në nëntor të vitit 1947. I deleguari i PKJ, Savo Zllatiç,¹⁵ artikuloi përpara udhëheqësve kryesorë shqiptarë akuzën se në praktikën e punës së KQ të PKSh po kristalizohej “një vijë e dytë antijugosllave në

¹² Velimir Stojnić, i deleguar i KQ PKJ pranë KQ PKSh, kishte ardhur në Shqipëri që në gusht 1944.

¹³ *Politikë antikombëtare e Enver Hoxhës. Plenumi i 2-të i KQ PKSh (Berat 23-27 nëntor 1944)*. Përgatitur nga Ndreçi Plasari dhe Luan Mallezi. Tiranë: 1996.

¹⁴ *Po aty*, f. 147. Në Plenumin e II të KQ PKSh, në Berat, V. Stojnić midis të tjerash tha: “Emri i Titos ka dalë përtej (jashtë) kuadrin të Jugosllavisë. Ai është simbol i çlirimit të popujve të shtypur nga reaksioni e fashizmi. Këtë emër më së miri duhet ta kuptojë populli juaj. Duhet të jetë pikërisht kështu, prandaj të popullarizoni emrin e Titos në Shqipëri. Të shkruhet në shtypin tuaj më shumë për Jugosllavinë. Duhet të popullarizohet Ushtria NÇ Jugosllave nëpërmjet shtypit, por më mirë nëpërmjet veprash konkrete bashkëpunimi”.

¹⁵ Pas largimit të Velimir Stojnićit, Savo Zllatiç ishte i deleguari i ri i KQ PKJ pranë KQ PKSh.

ekonomi”.¹⁶ Në mbledhjen e Byrosë Politike të 4 korrikut 1947, E. Hoxha e hodhi poshtë akuzën e të deleguarit jugosllav.¹⁷ Ndërsa për mosrealizimin e planeve ekonomike, vonesat, lëshimet e gabimet gjatë punës akuzoi si bashkëfajtorë dhe jugosllavët.

Në këtë situatë të tendosur, vizita e shumëpritur e E. Hoxhës në BS (14-26 korrik 1947) e thelloi pakënaqësinë e jugosllavëve ndaj udhëheqjes shqiptare. Në shtyp u tha se E. Hoxha shkonte në Moskë për një “vizitë miqësore”, por përbërja e delegacionit, ku përveç kryeministrit merrnin pjesë ministri i brendshëm, ministri i Drejtësisë, zëvendësministri i Jashtëm, drejtori i Personelit i Ministrisë së Mbrojtjes etj. sugjeronte se vizita ishte e një rëndësie të veçantë. Savo Zllatiçi, përfaqësuesi jugosllav pranë KQ PKSh, u lajmërua për këtë vizitë, një ditë para nisjes së delegacionit shqiptar dhe për këtë atij nuk i erdhi mirë.¹⁸ Nëse ishte koha e shkurtër për përgatitje apo mungesa e dëshirës për të shkëmbyer mendime me jugosllavët, këtë na e zbulon një mbledhje e Byrosë Politike e mbajtur disa muaj më vonë, në dhjetor 1947, ku edhe E. Hoxha edhe K. Xoxe pranojnë se ata e dinin që vizita nuk do të ishte vetëm miqësore, se me qëllim nuk u konsultuan me jugosllavët, pasi ata shkonin në Moskë për t’i diskutuar me sovjetikët edhe mosmarrëveshjet me jugosllavët. Ata pohojnë se “ne nuk u vumë në dukje jugosllavëve qëllimet e vajtjes, që ishin jo vetëm miqësore por edhe për çështje të tjera... Ne shkonim në Moskë me një mendim në lidhje me jugosllavët”.¹⁹

Akoma më tej, gjatë vizitës së E. Hoxhës në Moskë, ashtu si gjatë vizitës së Nako Spirut në maj,²⁰ sovjetikët nuk i ftuan jugosllavët për t’u bërë palë, apo për të qenë të pranishëm në bisedimet shqiptaro-sovjetike. Sigurisht të gjitha

¹⁶ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë / Arkivi i Partisë* (më tej: *AQSh/AP*), viti 1947, dos. 3, Mbledhje e Byrosë Politike më 4 korrik 1947.

¹⁷ *Po aty*, dos. 3. E.Hoxha në mbledhjen e Byrosë Politike më 4 korrik 1947, i përgjigjet përfaqësuesit jugosllav, Savo Zllatiçi se nga disa gabime e vonesa “nuk mund të nxirret deduksioni se këtu ka shtrembërim vije ose një vijë të dytë. Mund të ketë çdo gjë tjetër, dhe ka, por jo një vijë e dytë”.

¹⁸ *Po aty*, viti 1948, dos. 11.

¹⁹ *Po aty*, viti 1947, dos. 37, Mbledhja e Byrosë Politike më 5 dhjetor 1947.

²⁰ *AMPJ*, viti 1947, dos. 4. Sapo Nako Spiru kishte mbaruar vizitën e tij në Moskë, në maj 1947, ambasadori jugosllav Vladimir Popoviç i kërkoi takim ambasadorit shqiptar Mihal Prifti dhe me një ton të ashpër e pyeti atë se me kë ishte takuar Nako Spiru dhe çfarë marrëveshjesh ekonomike kishte nënshkruar. Ai kritikoi vijën e udhëheqjes shqiptare se ka dy tendenca, “një me u lidhë me Jugosllavinë, e tjetra me u lidh me BS. Por juve duhet të zgjidhni ose me njërin ose me tjetrin dhe jo me të dy”. Sipas ambasadorit jugosllav, shqiptarët nuk duhej të nënshkruanin asnjë marrëveshje ekonomike me ndonjë vend tjetër “pa u konsultuar ... e pa u marrë vesh më parë me ne (jugosllavët-A.L.)”, me të cilët kishin një traktat ekonomik.

këto ngjallën zemërim të madh në Beograd.²¹ E. Hoxha duhet ta ketë ndjerë këtë, pasi për të treguar korrektesë pas kthimit nga Moska, ai njoftoi për rezultatet e vizitës jo vetëm S. Zllatiçin, por në të njëjtën kohë ngarkoi dhe Tuk Jakovën, ambasadorin shqiptar në Beograd, të takonte Titon dhe ta informonte rreth vizitës. Megjithëse Tuk Jakova ia bëri me dije tri herë zëvendësministrit të jashtëm jugosllav, Vojvodës, se “në emër të komandantit duhej t’i komunikonte Mareshalit disa çështje”, Tito nuk e priti.²² Më në fund, më 14 gusht, Tuk Jakova do t’i shkruante E. Hoxhës se “në të vërtetë çështjes i iku aktualiteti”.²³

Vendosja e lidhjeve të drejtpërdrejta të Tiranës zyrtare me Moskën u konsiderua nga drejtuesit jugosllavë si gërryerje në zonën e tyre të influencës.²⁴ Këshilltarët dhe specialistët jugosllavë në Shqipëri shpreheshin hapur se “pas kthimit të Komandantit nga Moska kishte filluar një ftohtësi ndaj Jugosllavisë; nuk flitet për Titon, as shkruhet, as fotografitë nuk shihen, përveçse ato të Enverit dhe Stalinit, po kështu lëshohen vetëm parullat Enver-Stalin”, madje më të guximshmit flisnin dhe për “një kampanjë frontale kundra Jugosllavisë”.²⁵ Kur në muajt gusht, shtator, tetor filloi puna për hartimin e planit pesëvjeçar, situata u përkeqësua me shpejtësi. Jugosllavët përpiqeshin t’u impononin specialistëve dhe politikanëve shqiptarë konceptin se “baza e planit pesëvjeçar duhet të jetë që Shqipëria bën pjesë në sferën ekonomike me Jugosllavinë”.²⁶ Ndërsa Nako Spiru, Kryetar i Komisionit të Planit Shtetit dhe ministër i ekonomisë, që kishte ndjekur nga afër dhe kishte firmosur një varg marrëveshjesh shqiptare-jugosllave, e kishte kuptuar deformimin që po ndodhte në marrëdhëniet ekonomike ndërmjet dy vendeve: marrëveshje të paprecizuara mirë, firma të hedhura me nxitim, vonesa të materialeve, premtime të pambajtura, mosrealizime të planit etj. Si figura numër një e hartimit të Planit pesëvjeçar, N. Spiru synonte ta dobësonte tutelën jugosllave dhe në fshehtësi filloi konsulencat me specialistët sovjetikë në Shqipëri.

²¹ Nicholas Pano, *The People's Republic of Albania*, Baltimore, Maryland: 1968, p. 77. Autori i këtij libri, përveçse vëren shqetësimin e Titos nga përjashtimi i jugosllavëve në takimet me delegacionin shqiptar në Moskë, ai vjen edhe në një përfundim interesant kur thotë: “Stalini në mesin e vitit 1947 nuk ishte ende gati të kritikonte jugosllavët hapur për sjelljen e tyre në Shqipëri dhe as ishte i përgatitur t’i largonte ata nga pozita e tyre e favorizuar atje”.

²² *AQSh/AP*, viti 1947, dos. 5. Marrëdhëniet e PKSh me PKJ.

²³ *Po aty*, MPKJ, viti 1947, dos. 5.

²⁴ Agim Zogaj, *Fuqia e ideve*, NSHBI “Zëri” 1993, f. 29. Në një intervistë të dhënë në shkurt 1991, Milovan Gjilasi e konsideron këtë moment si “përzierje të BS rreth Shqipërisë” në politikën jugosllave.

²⁵ *AQSh/AP*, viti 1947, dos.8. Marrëdhëniet e PKSh me PKJ.

²⁶ *Ibidem*.

Këto veprime nuk mbetën pa u vënë re nga këshilltari jugosllav S. Zllatiç, i cili informoi në detaje KQ PKJ.²⁷ Tito i shqetësuar nga afrimi sovjetoshqiptar, si dhe rezistenca e nëndheshme e N. Spirut, në mesin e gushtit 1947, iu drejtua vetë ambasadorit sovjetik në Beograd, Lavrentiev, të cilit i shprehu pakënaqësinë e tij se ministri i ekonomisë shqiptare, N. Spiru “zhvillonte politikën e shkëputjes së Shqipërisë nga Jugosllavia.” Tito u shpreh se “nuk duhej të lejohej një mosmarrëveshje ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë”. Prandaj ai mendonte “të thërriste Enver Hoxhën dhe Koçi Xoxen në Beograd dhe t’i propozonte atyre ta largonin e mënjanonin nga puna Nako Spirun”.²⁸ Tito thirri në Beograd emisarin e tij Savo Zllatiç, i cili sapo u kthye në Shqipëri, ia përcolli akuzat e Titos për Nako Spirun personalisht Enver Hoxhës dhe Koçi Xoxes. “Ne nuk mund të mos vërejmë një rol të çuditshëm që luan Nako Spiru. Ne na duket se shoku Nako Spiru dëshiron orientimin antijugosllav dhe është mbrojtës i këtij orientimi...”.²⁹ Duket sikur Nakua ishte nyja gordiane, që kishte futur në kolaps marrëdhëniet shqiptare-jugosllave. Ajo që nuk thuhej në akuzën jugosllave dhe që fshihte thelbin e saj, ishte lidhja e fshehtë e N. Spirut me sovjetikët. Duke goditur Nakon, do të eliminohej figura kryesore e lidhjeve ekonomike të Shqipërisë me BS, dhe, do t’u jepej një mësim drejtuesve të tjerë shqiptarë se lidhjet me Jugosllavinë ishin alternativa e tyre e vetme.

Në këto momente, udhëheqësit shqiptarë ndjeheshin të çorientuar në qëndrimet e tyre. Në shtator 1947, Beogradi ishte shpallur vendqëndrimi i selisë drejtuese të Informbyrosë dhe vendet e Evropës Qendrore i kishin forcuar marrëdhëniet me Jugosllavinë nëpërmjet shkëmbimit të delegacioneve e vizitave të ndërsjella. Nga ana tjetër, E. Hoxha nuk kishte gjetur mbështetje në Moskë për ankesat e tij mbi ndihmën e pamjaftueshme jugosllave, përkundrazi, Stalini i kishte thënë se “Ju keni nevojë për ndihma, jugosllavët janë njerëz të mirë... Ju do t’i bëni punët nëpërmjet Jugosllavisë dhe ne do t’ju ndihmojmë”.³⁰ Fjalët e një anëtarit të Byrosë Politike shprehin qartë dilemat që ekzistonin te drejtuesit shqiptarë: “Ne nuk i kemi vënë rëndësinë e duhur Jugosllavisë. Tani e shohim se sa rëndësi i vuri asaj Konsulta Informative që lot një rol të rëndësishëm në demokracitë e reja... Ne nuk i kemi vënë rëndësi fjalës së Stalinit kur pyeti: Pse, populli juaj nuk është i kënaqur me marrëdhëniet me Jugosllavinë? Ne nuk i kemi analizuar pse i tha ai këto fjalë”.³¹

²⁷ *Arhiv Centralnog Komiteta Saveza Komunista Jugoslavije* (më tej: ACKSKJ), II, 1/I-135, List 34, Signature 8-I/75). Shih raportet e Savo Zllatiç dërguar KQ PKJ më 1 korrik 1947, në mesin e gushtit 1947, 9 nëntor 1947.

²⁸ *Vostochnaja Evropa v Dokumentah Rosijskih Arhivov 1944-1953*, Tom I, 1944 - 1948, dok. 233, Moskva-Novosibirsk: 1997.

²⁹ *AQSh/AP*, viti 1947, dos. 3.

³⁰ *Po aty*, dos. 23, Mbledhje e Byrosë Politike PKSh më 27 korrik 1947.

³¹ *Po aty*, dos. 33.

Savo Zllatiç, ashtu si paraardhësit e tij jugosllavë, duke përfituar nga përçarjet në Byronë Politike të PKSh, duke afruar herë një grup e herë një tjetër, arriti të sigurojë mbështetje dhe të përqëndrojë kundër N. Spirit sulmet e anëtarëve të Byrosë. Nga 6-18 nëntori 1947, Savo Zllatiç zhvilloi disa bisedime sekrete³² me E. Hoxhën dhe K. Xoxen³³, dy figurat qendrore të politikës shqiptare. Në takimin e 8 nëntorit 1948 me E. Hoxhën, S. Zllatiç do të shprehej se “Në Shqipëri ekziston një vijë, një qëndrim, një orientim që nuk është i pajtueshëm me atë që është vendosur në Plenumin e gjerë të dhjetorit 1946... Konstatohet rënie në lidhjet tona, sidomos në ekonomi... Ne nuk jemi të kënaqur me këto marrëdhënie, të cilat janë shumë të këqia... Nënçmimi i Krajgerit dhe i Peroviçit... Moskënaqësi e Partisë në hekurudhë... Te shoku Nako ka një gjë simptomatike, ka dyshim”.³⁴ Si përfundim, E. Hoxha dhe K. Xoxe ranë në ujdj që përgjegjësia e akuzës së KQ PKJ t’i ngarkohej vetëm N. Spirit.³⁵

Më 18 nëntor 1947, Enver Hoxha mblodhi Byronë Politike dhe i kërkoi N. Spirit, si njeriu përgjegjës i ekonomisë së vendit, të raportonte për qëndrimet antijugosllave të manifestuara në ekonominë shqiptare. Vetë E. Hoxha në atë mbledhje do të shprehej se: “Kjo çështje është e madhe, dhe kështu si e vënë jugosllavët, një rol të çuditshëm ka luajtur Nakoja, që do të thotë se ai ka tradhtuar interesat e popullit e të Partisë”.³⁶ Nako duke parë atmosferën e rënduar dhe mjaft delikate kërkoi një ditë kohë për përgatitje. Anëtarët e Byrosë Politike pranuan me vështirësi. Të nesërmen, më 19 nëntor, Nakua u takua me të ngarkuarin me punë të përkohshme sovjetik në Tiranë, A. N. Gagarinov (Chuhahini ishte thirrur në Moskë qysh nga gushti 1947, ku qëndroi deri në mars 1948), të cilit ia parashtrroi situatën dhe e quajti jo korrekt qëndrimin e Enver Hoxhës, që i “njohu tërësisht si të drejta akuzat e jugosllavëve” se N. Spiritu ishte “frymëzues i tendencave antijugosllave në Shqipëri”. “Kjo më kërcënon mua me vdekje”,³⁷ i tha ai Gagarinovit. Por Gagarinov, ndoshta jo shumë në dijeni të çështjes Nako Spiritu, nuk dha asnjë premtim e nuk mori

³² ACKSKJ, II, 1/I-135, List 34. Savo Zllatiç në raportin e tij dërguar KQ PKJ më 16 nëntor 1947, flet për një takim me K. Xoxen, me të cilin ka diskutuar për taktikat që do të përdorehin në mbledhjen e Byrosë Politike kundër Nako Spiritu, duke filluar që nga mosthirrja në Byro e mbështetësve të Nakos (Fadil Paçramit, Liri Belishovës, Bedri Spahiut), për qëndrimin e Nakos, i cili kishte informuar fshehurazi jugosllavët për tezat e Enver Hoxhës për rishikimin e Plenumit të Beratit etj.

³³ Koçi Xoxe ishte sekretar i KQ PKSh, zëvendëskryeministër dhe ministër i Brendshëm.

³⁴ ACKSKJ, II, 1/I-135, List 34.

³⁵ AQSh/AP, viti 1947, dos. 3. Mbledhja e Byrosë e PKSh më 8 nëntor 1947.

³⁶ Po aty, dos. 33. Shih mbledhjen e Byrosë Politike të KQ më 18 nëntor 1947.

³⁷ *Vostoçnaja Evropa v Dokumentah ...*, dok. 250.

asnjë angazhim. Pas kësaj mbledhjeje, N. Spiru kreu vetëvrasje,³⁸ gjë që krijoi alibinë se akuzat e PKJ ishin të drejta.

Gjatë nëntorit dhe dhjetorit 1947, u mbajtën një varg mbledhjesh të Byrosë Politike që i dhanë vijën plenumit të ardhshëm të KQ PKSh, Në këto mbledhje, kritikant ndaj Nakos, pas vdekjes, ishin të ashpra dhe denigruese. Vetë E. Hoxha do t'ua paraprinte kritikave ndaj N. Spirit dhe lidhjeve federative me Jugosllavinë: “Ne, deklaronte ai, duhet të shikojmë bashkëpunimin tonë tash e në të ardhmen; ne po ndërtojmë ekonominë e vendit tonë me baza federative dhe kjo nuk duhet të interpretohet se ne humbasim lirinë, sovranitetin, independencën siç mendonte Nako...; bashkimi e vëllazërimi duhet të jetë i ngushtë në të gjithë sektorët...”³⁹

Në këtë frymë u diskutua dhe në Plenumin e VIII KQ PKSh që u mbledh në shkurt-mars 1948. Të gjitha diskutimet u përqendruan në dënimin e N. Spirit duke pohuar se “ekzistonte një fraksion në KQ PKSh me në krye N. Spirun..., N. Spiru bënte që teknikët jugosllavë të likuidoheshin..., ai vrau veten si armik dhe si tradhtar..., Jugosllavia na ka ndihmuar shumë dhe të mendosh për shkëputje është vetëvrasje..., ne si komunistë jemi për një bashkim të plotë etj.”⁴⁰ Vetë E. Hoxha arriti t'ia hedhë paq, duke u pozicionuar herë si flamurtar i rrugës federaliste dhe i dënimit të N. Spirit, herë duke ftuar shokët që të hapin barqet dhe herë duke bërë autokritikë se nuk ishte treguar vigjilent pasi Nako kishte dhe ndihmën e tij, dhe se, me dashje ose pa dashje ai kishte ndihmuar në fraksionin në parti.⁴¹ Madje në përfundim të plenumit, E. Hoxha së bashku me K. Xoxen takuan Chuvahinin dhe i shprehën atij kënaqësinë se “Në Partinë tonë është arritur një unitet i plotë”.⁴² Plenumi VIII i KQ PKSh shënoi një fitore të plotë të jugosllavëve. Për ko incidencë, atë ditë që në Moskë, Stalini hidhte firmën në letrën e 27 marsit drejtuar KQ PKJ, atë ditë, në Tiranë, E. Hoxha

³⁸ *AQSh/AP*, Fondi 14, viti 1947, dos. 52; Ibidem, viti 1948, dos. 42. Më 21 nëntor u dha lajmi në radio se N.S. ishte vrarë aksidentalisht duke luajtur me revole në zyrën e tij në mbrëmjen e 20 nëntorit. Ngjarja ndodhi gjysmë ore para se të fillonte mbledhja e Byrosë Politike. Ai u varros me nderime nga qeveria. Më vonë u tha se N.S. kishte vrarë veten. Në mbledhjet e Byrosë Politike, në plenumet dhe në organizatat e PKSh, ai cilësohej si armik, që ishte përpjekur të prishte marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Ndërkohë në popull pëshpëritej se Nako Spirun e kishin vrarë. Por për vrasjen, vetëvrasjen, apo vrasjen aksidentale të tij nuk pati kurrë një raport zyrtar. U rehabilitua pas kongresit të parë të PKSh, ku u quajt “viktimë” e intrigave të udhëheqjes jugosllave.

³⁹ *Po aty*, dos. 42. Mbledhja e Byrosë Politike PKSh më 10 dhjetor 1947.

⁴⁰ *Marrëdhëniet shqiptaro jugosllave, 1945-1949, Dokumente*. Përgatitur nga Ndreçi Plasari dhe Luan Malltezi, Tiranë: 1996, f. 245, 246, 255, 259, 295, 304.

⁴¹ *Po aty*, f. 246-247.

⁴² *Vostoçnaja Evropa v Dokumentah ...*, dok. 266.

firmoste Rezolucionin e Plenumit të KQ PKSh,⁴³ ku legjitimohej politika drejt bashkimit federativ të Shqipërisë me Jugosllavinë dhe përcaktoheshin detyra konkrete për realizimin e kësaj politike nga udhëheqja politike shqiptare.⁴⁴

3. Jugosllavët nxitojnë

Kur udhëheqësit jugosllavë bënëin përpjekje për t'u dhënë marrëdhënieve ekonomike shqiptaro-jugosllave dimensionet e dëshiruara prej tyre, Tito përshpejtoi hapat për të krijuar e konsoliduar një segment tjetër të lidhjeve federative Jugosllavi-Shqipëri, ato ushtarake. Ai dërgoi në Tiranë disa nga ushtarakët e tij më me përvojë,⁴⁵ për të përshpejtuar procesin e unifikimit të dy ushtrive, asaj shqiptare dhe asaj jugosllave. Në fund të vitit 1947 ka një Promemorie për bashkimin e ushtrisë shqiptare me ushtrinë jugosllave, të përgatitur nga ekspertët e Shtatmadhorive të të dy vendeve dhe që i parashtrohej për miratim komandantëve supremë të ushtrisë jugosllave dhe ushtrisë shqiptare. Aty flitej për strukturat e përbashkëta në kohë paqeje dhe në kohë lufte, buxhetin, armatimet, stërvitjet ushtarake, punën ideopolitike etj.⁴⁶ U bënë dhe ndryshime në udhëheqjen e ushtrisë shqiptare, duke larguar drejtuesit që i rezistonin politikës jugosllave dhe vënë të tjerë që e pranonin ndërhyrjen e saj.⁴⁷ Pikërisht në këtë kohë, më 19 janar 1948, Rankoviçi nëpërmjet një radiogrami i dërgonte E. Hoxhës mesazhin e Titos për të ardhur në Shqipëri një divizion ushtarak jugosllav, i cili do të vendosej në zonën e Korçës.⁴⁸ Të

⁴³ Plenumi VIII PKSh u mbledh më 26 shkurt-8 mars 1948. Kurse Rezoluta e tij u miratua më 27 mars 1948.

⁴⁴ *Marrëdhëniet shqiptaro jugosllave ...*, f. 424. Në Rezolucionin e Plenumit VIII KQ PKSh midis të tjerash shkruhej: “Nako Spiru u përpoq me të gjitha forcat e tij që ekonomia e vendit të zhvillohej në mënyrë independente dhe e shkëputur nga ekonomia e Jugosllavisë... Partia e shikon se bashkimi ekonomik në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe gjithë format e bashkëpunimit në mes tyre, që rrjedhin nga ky bashkim, përbëjnë hallkën kryesore që sot në praktikë na sigurojnë këtë rrugë.”

⁴⁵ Gjatë vitit 1947 dhe muajt e parë të vitit 1948, me porosi të Titos erdhën në Tiranë disa nga ushtarakët e tij më me përvojë, si gjenerali Koça Popoviç, shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë jugosllave; gjeneral Vukmanoviç Tempo, drejtor politik i ushtrisë Jugosllave; gjeneral Rade Hamoviç, zëvendësi i Tempos; gjeneral Milan Kupreshanin, komandant i Armatës III të ushtrisë jugosllave etj. Për kontributin që dhanë për unifikimin e ushtrisë shqiptare, ata u dekoruan nga Kuvendi i Shqipërisë.

⁴⁶ *Marrëdhëniet shqiptaro jugosllave ...*, f. 149-152. Cituar sipas: *Arkivi Qendror i Ushtrisë*, Fondi: Shtatmadhoria, viti 1947, dos. 42.

⁴⁷ U largua komandanti i Shtabit të Përgjithshëm, Mehmet Shehu dhe u emërua Beqir Balluku; u vendos drejtor i drejtorisë politike të ushtrisë shqiptare, Kristo Themelko, i preferuar i jugosllavëve.

⁴⁸ *Marrëdhëniet shqiptaro jugosllave ...*, f. 402; *Arhiv Predsednika Republike* (Arhiv Josipa Broza Tita). KMJ. I-3-b/651, shih telegramin e Rankoviçit dërguar

nesërmen, më 20 janar 1948, E. Hoxha iu përgjigj pozitivisht J.B.Titos, duke i shkruar se “pres sugjerimin nga ana juaj për mënyrën dhe momentin për ta kryer këtë detyrë”.⁴⁹ Atëherë, më 26 janar 1948, Tito dërgoi në Tiranë gjeneral Milan Kupreshanin, i cili do të merrej me organizimin e punës parapërgatitore për dislokimin e divizionit jugosllav, krahas unifikimit të dy ushtrive. M. Kupreshanin i dorëzoi E. Hoxhës dhe një letër të Titos, ku përsëritej kërkesa për vendosjen e divizionit në Korçë dhe përcaktohej rendi dhe mënyra sekrete e veprimeve.⁵⁰ Në kujtimet e veta Hoxha thotë se nuk dha përgjigje për letrën, nuk mblodhi as Byronë Politike për të diskutuar kërkesën që u bëhej, por me iniciativën e vet njoftoi ambasadën sovjetike.⁵¹ Në pikëpamje formale ka një manipulim që ia vlen të përmendet. Letra e Titos është e datës 26 janar 1948. Kjo letër gjendet në arkivat shqiptare. Por nuk gjendet një përgjigje për letrën dhe është e mundshme të mos i jetë kthyer fare përgjigje. Arsyeja është e thjeshtë. Përgjigja i është kthyer me telegram Rankoviçit, më 20 janar. Në arkivat shqiptare nuk janë as kërkesa e Rankoviçit në emër të Titos, më 19 janar, dhe as përgjigja e Hoxhës, më 20 janar. Por këto janë në arkivat jugosllave.⁵² Pavarësisht kësaj mungese, një dokument tjetër qartësisht konfirmues është mbledhja e Byrosë Politike, më 3 mars, ku Hoxha vë në dijeni Byronë për gjithë sa ka ndodhur: “Për mbrojtjen e kufijve tanë do të vinte një divizion jugosllav në Korçë. Për këtë na lajmëroi Rankoviçi dhe më vonë Titoja, si për divizionin, ashtu edhe për shpalljen e zonës së Korçës, zonë në

Gjilasit në Moskë më 29 janar 1948. Më 19 janar 1948, A. Rankoviç, ministër i brendshëm jugosllav, zëvendëskryeministër dhe sekretar organizativ i PKJ, nëpërmjet një radiogrami i bënte me dije E. Hoxhës që në qeverinë greke diskutohej për mundësinë e një sulmi ndaj Shqipërisë me qëllim aneksimin e pjesëve jugore të saj dhe se në këtë situatë mareshali kërkonte sektorin e Korçës, që ndodhet afër kufijve jugosllavë, për vendosjen e një divizioni me qëllim mbrojtjen e përbashkët të kufijve jugosllavë dhe shqiptarë.

⁴⁹ *AQSh/AP*, viti 1948, dos. 64; *Arhiv Predsednika Republike* (Arhiv Josipa Broza Tita) KMJ, 1-3-b/34.

20 janar 1948. br. 25; Leonid Gibianskii, *Novaja novejsnjaja istorija*, Moskva: 1996, mart-aprel, No. 2. f. 158. “Kominform v dejstvii, 1947-1948 g. Po arhivnim dokumentam”.

⁵⁰ *Marrëdhëniet shqiptaro jugosllave ...*, f. 208. Në letrën e 29 janarit 1948, Tito i shkruante E. Hoxhës se përgatitjet për divizionin duhej të realizoheshin në mënyrë të qetë dhe pa u kuptuar..., për sqarim shtypit, po të më pyesin mua ose ju, t’i përgjigjemi se kjo bazë është dhënë me marrëveshje për nevojat e sigurimit jo vetëm të kufijve shqiptarë, por edhe të atyre jugosllavë në lidhje me provokacionet gjithnjë më të shpeshta të monarkofashistëve grekë”.

⁵¹ Enver Hoxha, *Titistët*, Tiranë, 1982, f. 404-410.

⁵² Është fjala për burimin jugosllav të përmendur në këtë punim *APR KMJ 1-3-b/34* dhe *APR KMJ 1-3-b-651*, nr. 547.

gjendje lufte. Mareshalit iu përgjigjëm *po* dhe morëm masa për të spostuar divizionin tonë më poshtë, në Leskovik etj.”⁵³ Ka edhe mospërputhje të tjera në këtë histori të Hoxhës, por objekt i këtij punimi nuk është aspak oponenti për kujtimet e liderit komunist shqiptar.

Pikërisht në këtë moment udhëheqësit shqiptarë, ndoshta të frikësuar apo ndoshta të ndërgjegjësuar për përgjegjësinë e madhe të vendimit që kishin marrë, lajmëruan dhe sovjetikët. Nga qeveria sovjetike erdhi përgjigja se ajo “nuk kishte dijeni dhe se ajo dyshonte nëse kishte ndonjë përgatitje për sulm të Greqisë kundër Shqipërisë.”⁵⁴

Dokumentet ruse dhe jugosllave hedhin dritë mbi lëvizjet e qeverisë sovjetike për t’u informuar mbi vërtetësinë e informacionit shqiptar. Në fund të janarit 1948 (28 dhe 31 janar) dhe në fillim të shkurtit (1 shkurt), me porosi të Molotovit, ambasadori sovjetik në Beograd, A.I.Lavrentiev bëri disa takime me Titon për këtë problem. Sovjetikët ishin të shqetësuar se këto veprime po bëheshin pa njoftuar Moskën, me të cilën Beogradi kishte dhe një Traktat të Ndhmës Reciproke. Fillimisht mesazhi i Molotovit për Titon ishte se angloamerikanët do ta konsideronin lëvizjen e trupave të ushtrisë jugosllave në Shqipëri si “një akt pushtimi të Shqipërisë nga ushtria jugosllave dhe një shkelje të sovranitetit të saj”, gjë që mund të përdorej si “pretekst për ndërhyrje në këto çështje”.⁵⁵ Më vonë, ai i tërhiqte vëmendjen Titos se qeveria sovjetike nuk mund të pranonte që “të vihet përpara faktit të kryer dhe se nuk është e përgatitur që të mbajë përgjegjësitë për një veprim të tillë të Jugosllavëve”.⁵⁶ Pas këtyre kritikave, Tito pranoi se kishte bërë një “gabim serioz” që kishte marrë vendim pa u këshilluar me Moskën. Ai i premtoi ambasadorit sovjetik A.I.Lavrentiev se nuk do të dërgonte trupa ushtarake në Shqipëri dhe do të këshillohej paraprakisht me Moskën për çështje të tilla në të ardhmen. Për rrjedhojë, Tito urdhëroi të deleguarin e tij ushtarak në Shqipëri, gjeneral Kupreshanin, që t’i komunikonte qeverisë shqiptare ndërprerjen e planit për ardhjen e Divizionit.

⁵³ *AQSh/AP*, Organet Udhëheqëse (më tej: OU), viti 1948, dos. 64, *burim i përm.* Shih edhe: *Po aty*, dos. 82. Në procesverbalin e mbledhjes së Byrosë Politike, më 25 prill 1948, shënohet që E. Hoxha të ketë thënë, ndër të tjera: “Ne kemi qenë plotësisht d’accord (në pajtim-A.L.) me ardhjen e divizionit, por kemi vënë në dijeni qeverinë sovjetike *à titre d’information* (me qëllim informacioni-A.L.) dhe kemi vazhduar të merren të gjitha masat, siç kishim rënë d’accord (me jugosllavët, A. L.)”. Shih edhe *AQSh/AP*, MPKBS, viti 1948, dos. 5.

⁵⁴ *AQSh/AP*, viti 1948, dos. 64, fl. 7.

⁵⁵ Jeronim Perovic, “The Tito – Stalin Split: A Reassessment in Light of New Evidence”, in *Journal of Cold War Studies*, Volume 9, Number 2, Spring 2007.

⁵⁶ *Po aty*.

Pas këtij momenti fillon një lojë e dyfishtë e Beogradit ndaj Shqipërisë. Nga një anë, hapur, Tito nëpërmjet gjeneral M. Kupreshaninit dërgon mesazhin e mosardhjes së Divizionit jugosllav në Shqipëri, nga ana tjetër, po ky gjeneral Kupreshanin së bashku me këshilltarin jugosllav S. Zllatiç dhe me ambasadorin jugosllav Josip Gjergjia, nxisnin shqiptarët se duhej të tregoheshin më energjikë pasi “ishite çështja e tyre” dhe se duhej t’i kërkonin qeverisë sovjetike të jepte OK për ardhjen e Divizionit jugosllav në Shqipëri. Sipas tyre, BS nuk mund t’i ndjente dhe gjykonte situatat e vështira me Greqinë, ashtu si mund t’i kuptonin shqiptarët.⁵⁷ Nën presionin e Kupreshanit, por edhe se e ndjenin veten të dobët për të mbrojtur pavarësinë e vendit përballë një sulmi të mundshëm grek, E. Hoxha dhe K. Xoxe takuan Çuvahinin dhe ia bënë të njohur atij situatën e vështirë në ushtrinë shqiptare për armatime, njerëz, furnizime ushqimore dhe kërkuan që të lejohej Divizioni jugosllav të vinte në Shqipëri.⁵⁸

Sovjetikët shprehën dyshimin e tyre për kërkesën e E. Hoxhës dhe K. Xoxes se mos ishin shtyrë nga jugosllavët. Megjithatë pala shqiptare mbajti qëndrim të vendosur, dërgoi edhe një telegram në Moskë për ndryshimin e vendimit, përgjigja ishte se “qeveria sovjetike nuk merrte përgjegjësi këshillimi, sa kohë që qeveria jugosllave nuk e kishte ngritur këtë çështje pranë tyre dhe sa kohë që ajo nuk po i dërgon forcat”.⁵⁹ Udhëheqja shqiptare e kuptoi se jugosllavët nuk ishin koordinuar me sovjetikët për problemin e Divizionit, e për rrjedhojë, e ndjeu veten pezull, të pafuqishme e konfuze. Megjithatë duke i konsideruar provokacionet greke në kufirin jugor si një rrezik real, ajo vazhdoi t’u bindej urdhrave të ushtarakëve jugosllavë për zgjerimin e rrugëve, urave, kazermave, zhvendosjen e trupave ushtarake në gjithë Shqipërinë për instalimin e forcave ushtarake jugosllave që do të vinin në Shqipëri në rast sulmi nga Greqia. Në thelb, kjo ishte përgatitje në fshehtësi për ardhjen e divizionit jugosllav.

4. Shqiptarët në Federatën e Sllavëve të Jugut?

Gjithë këto zhvillime kishin në sfond idenë delikate të një federate të Sllavëve të Jugut, ku do të përfshihej edhe Shqipëria. Nëse Shqipëria do të ishte njësi më vete apo republikë e shtatë e Jugosllavisë, kjo nuk u përcaktua

⁵⁷ AMPJ, viti 1948, dos. 176. Sipas S. Zllatiçit, M. Kupreshaninit dhe J. Gjergjias “BS shikon ndryshe dhe larg, kurse ne i kemi mbi lëkurë dhe na djegin. Bashkimit Sovjetik mund t’i bëjnë përshtypje provokacionet greke dhe gjëra që ngjasin në kufirin tonë, aq sa mund të më bëjë mua përshtypje një incident kufiri në Kore. Kur e pyes BS se çfarë bën ai kur një aeroplan armik kapërcen kufirin e tij, ai përgjigjet se: “E qëllojmë”. Kurse ne na këshillohet që të jemi prudentë etj.”

⁵⁸ AQSh/AP, viti 1948, dos. 64, fl. 8. Diskutimi i E. Hoxhës në mbledhjen e Byrosë Politike të PKSh më 3 mars 1948.

⁵⁹ Po aty.

asnjëherë. E shtruar herë në formë sondazhi e herë si presion nga jugosllavët, nuk u arrit të hartohej e të punohej mbi një Projekt të përbashkët organizativ, ekonomik, ushtarak e politik. Tezat e para për “bashkim” midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë u shtruan më 5 dhjetor 1947 nga Savo Zllatiç. Aty flitej për bashkëpunim ekonomik e ushtarak midis tre vendeve, Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Bullgarisë, me qëllim që “çdo ditë bashkimi i tyre të bëhet më i shëndoshë”. Pasi vihej në dukje se “në fakt, në praktikë, ne bëjmë federatën”, shprehej mosbesimi ndaj Shqipërisë, e cila “nuk mund të rronte vetë, kurse Bullgaria, po”.⁶⁰ Në tezat nuk thuhej asnjë fjalë për struktura konkrete të përbashkëta shtetërore politike, ekonomike dhe ushtarake. Pothuajse gjashtë javë pas paraqitjes së Tezave, më 19 janar 1948, Tito shtroi kërkesën për ardhjen e divizionit jugosllav në Shqipëri. Duke sjellë ndër mend se Tito kishte përvojën e dhunës për aneksimin e Kosovës, kemi arsye të mendojmë se rruga drejt federatës ishte projektuar të bëhej nën diktatin dhe po të ishte e nevojshme, me ndërhyrjen e ushtrisë jugosllave. Në mbështetje të kësaj teze, mund të sjellim dhe fjalët e Kardelit disa muaj më vonë, në mbledhjen e Byrosë Politike të PKJ më 1 mars 1948, kur ai u shpreh se: “Shqipërinë duhet ta mbajmë fort, sepse për atë kemi investuar dhe ajo për ne është e rëndësishme. Nuk do të shkojë atje vetëm një divizion, por dhe forca më të mëdha që ta marrim”.⁶¹

Por ndërsa në fund të vitit 1947 e fillim të vitit 1948, Tito po nxitohet për ta bërë fakt të kryer bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, Stalini vepronte në një kah tjetër. Në historinë e marrëdhënieve shqiptare-jugosllave ka një moment për të cilin nuk është folur deri më sot, por që dëshmon se Stalini, në fund të vitit 1947, po ndërmernte hapa konkretë për të zhvendosur ekskluzivitetin jugosllav mbi Shqipërinë. Në fillim të dhjetorit të vitit 1947, kur N. Spiru, ministri i ekonomisë, sapo kishte vlarë veten,⁶² dhe kur udhëheqësit shqiptarë rrekeshin të zbulonin gabimet e tij e të njëri-tjetrit dhe të penduar solidarizoheshin me “vijën e drejtë” të PKJ,⁶³ E. Hoxhës i erdhi nga Dimitrovi

⁶⁰ *Marrëdhëniet shqiptaro jugosllave ...*, f. 134-138.

⁶¹ *Izvori za istoriju Jugoslavije, Politbiro Centralnog Komiteta Komunističke Partije Jugoslavije 1945-1948*, Beograd: 1995, s. 240. Nga kjo përmbledhje dokumentesh fjalët e E. Kardelit në origjinal janë: “Ne bi išla sama divizija već bi išli sa većim snagama, pa šta ko ugrabi”. Gjithsesi kjo frazë mbetet në një kontekst të dyshimtë, duke u nënkuptuar ndoshta një ndërhyrje e mundshme ushtarake në Shqipëri nga ana e Greqisë. Shiko gjithashtu: B. Petranović, *Balkanska Federacija, 1943-1948*, Beograd: 1991, f. 200.

⁶² Nako Spiru, një ditë para vrasjes, në takimin me të ngarkuarin me punë në ambasadën sovjetike, A.N.Gagarinov, la një letër për Stalinin, ku informonte për politikën jugosllave në Shqipëri. Kjo letër nuk iu dorëzua asnjëherë E. Hoxhës, pavarësisht nga kërkesa e tij.

⁶³ *AQSh/AP*, viti 1948, dos. 53. Në mbledhjen e Byrosë Politike, më 22 janar 1948, E. Hoxha do të shprehej se “Ato që thashë i them prapë, se të gjithë sektorët të

“ftesa e papritur”, siç e quan ai në librin e tij me kujtime “Titistët”, për të vizituar Bullgarinë. Në shtypin shqiptar u shkrua se E. Hoxha do të nënshkruante në Bullgari një “konventë kulturore”, kurse në shtypin bullgar u shtua se E. Hoxha do të nënshkruante “edhe konventa të tjera”. E. Hoxha pohon në librin e tij se në Sofje, Dimitrovi “propozoi nga ana e tij që të firmosej edhe në mes të Bullgarisë dhe të Shqipërisë një Traktat miqësie dhe ndihme reciproke, gjë që e kishim parashikuar edhe ne”.⁶⁴ E vërteta është se në arkivat shqiptare nuk gjendet asnjë letërkëmbim që të dëshmojë për nënshkrimin e ardhshëm të Traktatit. Por sidoqoftë është naive të besosh se një traktat miqësie e ndihme reciproke midis dy shteteve mund të nënshkruhet pa asnjë përgatitje dhe thjesht nga një propozim i çastit. Në ndihmë na vinë dokumentet ruse, të cilat dëshmojnë se nënshkrimi i Traktatit ishte një veprim i koordinuar midis Moskës dhe Sofjes. Në takimin e 7 dhjetorit 1947, Gj. Dimitrovi, kryeministri i Bullgarisë, i kërkonte S.P. Kirsanovit, ambasadorit sovjetik në Sofje, që ta kujtonte “udhëheqjen sovjetike për kërkesën e qeverisë bullgare për të dhënë mendimin për projektin e Traktatit të Ndhmës Reciproke midis Bullgarisë e Shqipërisë, i cili do të nënshkruhet në kohën e qëndrimit të E. Hoxhës në Sofje”.⁶⁵ Gjithashtu ka edhe një telegram shifër të ambasadorit shqiptar në Moskë, Mihal Priftit, dërguar Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë, i cili bën fjalë për popullarizimin që donin t’i bënin sovjetikët vizitës së E. Hoxhës në Sofje: “Para marrjes së njoftimit tuaj, sovjetikët janë interesuar të dinë rëndësinë e rezultateve të vizitës së Komandantit në Sofje. Na kërkojnë një artikull mbi rëndësinë e marrëveshjes që do të bëhet”.⁶⁶ Akoma më tej, E. Hoxha shkoi në Sofje duke u ndalur një natë në Beograd, ku takoi edhe Titon. Në bisedën e tyre nuk është thënë asnjë fjalë mbi Traktatin. Për më tepër u la që në kthim të bisedoheshin shtruar disa çështje të përbashkëta. Por kur E. Hoxha në rrugën e kthimit qëndroi në Beograd, as Tito⁶⁷ dhe as udhëheqësit e tjerë jugosllavë nuk e pritën, gjë që flet për pakënaqësi të palës jugosllave, e cila përsëri e ndjeu veten të nxjerrë jashtë loje lidhur me Shqipërinë.

shkojnë në atë rrugë, me baza federale, duke qenë kështu Sekretari i Përgjithshëm Titoja. Kështu vendi do të shkojë në një federatë”.

⁶⁴ E. Hoxha, *Titistët*, f. 373. Vizita e E. Hoxhës në Bullgari zgjati nga 13-18 dhjetor 1947, ndërsa Traktati i Miqësisë dhe Ndhmës Reciproke u nënshkrua nga E. Hoxha dhe Gj. Dimitrov, në Kritçim, më 16 dhjetor 1948. Vizita në Bullgari ishte vizita e tretë e E. Hoxhës jashtë Shqipërisë, pas asaj në Beograd (qershor 1946) dhe në BS (korrik 1947).

⁶⁵ *Vostočnaja Evropa v Dokumentah ...*, dok. 253.

⁶⁶ *AMPJ*, viti 1947, dos.82, fl. 16. Telegram shifër i ambasadorit shqiptar në Moskë, Mihal Priftit dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme.

⁶⁷ Tito në atë ditë ishte në Rumani ku nënshkroi një Traktat miqësie dhe ndihme reciproke Jugosllav-Rumun.

Duke konsideruar bashkimin ekonomik dhe ushtarak si dy shtyllat kryesore të federatës, jugosllavët bënë edhe një varg lëvizjesh politike për sendërtimin e saj. Në rrugë jo zyrtare, S. Zllatiç dhe M. Kupreshanin u sugjerorin drejtuesve shqiptarë të merrnin ata vetë iniciativën dhe të kërkonin federatën, pavarësisht nga Bullgaria e pavarësisht nga faktori i jashtëm.⁶⁸ Situatën e ndërlikoi edhe më shumë një letër e ambasadorit shqiptar në Bullgari, Teodor Heba, i cili në një takim që kishte pasur më 27 shkurt 1948, me kryeministrin bullgar, Gj. Dimitrov, ky i fundit i ishte shprehur në konfidencë se së shpejti çështja e federatës do të shtrohej ndërmjet KQ PKB dhe KQ PKJ dhe pasi ata të binin dakord, çështja do të shtrohej edhe me KQ PKSh. Kur të ishte kryer në fshehtësi e gjithë puna, gjë që parashikohej në qershor 1948, federata do të miratohej nga të tre parlamentet. Kështu, deri në fund të vitit 1948, bashkimi i tre shteteve do të kishte përfunduar.⁶⁹ Ambasadori shqiptar ishte i befasuar nga një lajm i tillë, pasi ai ishte në dijeni të deklaratave të Gj. Dimitrovit në kthimin e tij nga Rumania, më 17 janar 1948 dhe të kritikës që “Pravda” i kishte bërë atij më 28 janar 1948⁷⁰.

⁶⁸ *Marrëdhëniet shqiptaro jugosllave ...*, f. 416.

⁶⁹ *AMPJ*, viti 1948, dos. 8, fl. 72. Letra e ambasadorit Teodor Heba mban datën 1 mars 1948. Sipas letrës kryeministri bullgar Gj. Dimitrov i ishte shprehur në konfidencë ambasadorit shqiptar se: “Duhet të fillojmë nga puna për të vue bazat e Federatës në mes të tre shteteve tona: Jugosllavi, Bullgari dhe Shqipëri. Kjo s’duhet shty më gjatë. Kam bisedue dhe me shokun Stalin, i cili megjton po ashtu se nuk duhet shty më. Për këtë qëllim ne duhet të punojmë për përgatitjen e saj në heshtje dhe në momentin oportun t’a realizojmë. Duhet punue në konspiracionin më të madh që të mos të kuptojnë gjë imperialistët amerikanë, të cilët mund të shtyhen kështu shpejt të bëjnë ndonjë veprim edhe më të keq në Greqi. Për këtë qëllim Komiteti Qendror i Partisë sonë dhe KQ PKJ do ta shqyrtojnë shpejt për ta shtruar praktikisht realizimin dhe mbasi të kemi rënë dakord dhe me KQ të PKSh, mejtoj se nga qershori i këtij viti mund të mblidhen parlamentet e tre vendeve tona që t’i japin mandat shpejt zyrtarisht organeve të shtetit për zbatim dhe realizim, por kjo do të bëhet pasi e gjithë puna të jetë kryer. Këtë gjë nuk duhet t’ia thoni kërkujt, veç punoni për afrimin e popujve tanë sa më shumë, që kështu të jenë futur rrënjët në masa, për një vepër të tillë. Kështu do t’i vihemi përballë armikut në një front, të tre shtetet. Shqipëria kështu do të jetë me shpatulla më të ngrohta, nuk mund të jetë më objekt provokacionesh të dendura, siç po ndodh sot tue e konsiderue atë si vendin më të dobët prej tre vendeve tona. Unë besoj se kjo mund të realizohet para vitit të ri të ardhshëm. Por unë uroj që vitin e ri ta festojmë njësh, së bashku të tre”.

⁷⁰ Më 17 janar Gj. Dimitrov u foli gazetarëve perëndimorë për perspektivat e shkrirjes së “demokracive popullore” të Evropës Lindore në një shtet federativ, përfshirë dhe Greqinë. Të nesërmen kjo deklaratë u botua në gazetën “New York Times” dhe Stalini e qortoi Dimitrovin. Për shkak të reagimeve të ndërkombëtarëve, “Pravda” doli me një kritikë të hapur. Më tej, qeveria bullgare bëri një njoftim zyrtar se pranonte totalisht pozitën sovjetike, ndërsa Dimitrovi hodhi poshtë publikisht deklaratën e vet.

Por ambasadorit shqiptar i mungonte informacioni për mbledhjen e 10 shkurtit 1948 në Moskë, ndërmjet udhëheqësve më të lartë bullgarë, jugosllavë e sovjetikë dhe vendimi i Stalinit për krijimin e federatës fillimisht nga Bullgaria dhe Jugosllavia dhe pastaj të përfshihej në të dhe Shqipëria. Megjithëse anëtarët e Byrosë Politike të PKSh nuk dinin për zhvillimet në Kremlin, letra e ambasadorit Heba në Bullgari u tregonte atyre se kishte ardhur “një moment i ri”.⁷¹ Ata e ndjenë veten të zhvendosur dhe pse jo, të rrezikuar jashtë bashkimit federativ. Të pakënaqur, disa prej tyre u shprehën se “Meqë ne jemi më afër, duhet ta shtrojmë më parë (se bullgarët-A.L.)”.⁷² Letra i nxiti udhëheqësit shqiptarë të tregoheshin më të vendosur për bashkimin me Jugosllavinë. “Ne kemi qenë gjithmonë për bashkimin..., ne jemi për bashkimin, që ta bëjmë sa më parë”, kjo ishte fryma e diskutimeve në mbledhjen e Byrosë më 14 mars 1948. Por ndërkohë, udhëheqësit shqiptarë druheshin të merrnin ata iniciativën për bashkim, siç sugjerorin “jo zyrtarisht” Savo dhe Kupreshanin. Sipas drejtuesve shqiptarë, kjo çështje ishte me një rëndësi ndërkombëtare dhe “nuk varej vetëm nga ata”. Të ndodhur në këtë udhëkryq, u vendos që të pyeteshin jugosllavët e më vonë edhe sovjetikët. Në një letër të drejtuar Titos pas mbledhjes, më 17 mars 1948, E. Hoxha pasi pohonte se populli shqiptar e donte me gjithë zemër bashkimin, i kërkonte atij “këshilla dhe sqarime të mëtejshme për situatën e jashtme dhe ... nëse ka ardhur momenti ku neve duhet të marrim në shqyrtim çështjen e bashkimit dhe të mbërrijmë në konkluzione”.⁷³ Por letra e E. Hoxhës megjithëse ishte e mirëseardhur për jugosllavët, nuk e kënaqi Titon, i cili ktheu një përgjigje negative. Më 30 mars, S. Zllatiç, për çudinë e shqiptarëve, i solli E. Hoxhës mesazhin verbal të Titos “se nuk kishte ardhur momenti që të bëjmë federatën”.⁷⁴ Dukej një histori e ngjashme me atë të gjeneralit Milan Kupreshanin, i cili në shkurt kishte lajmëruar anulimin e vendimit për ardhjen e divizionit.

Arsyeja ishte se më 1 mars 1948, Byroja Politike e PKJ kishte marrë vendim për të mos u pranuar rekomandimi i Stalinit për federim me Bullgarinë “pasi BS kishte mbi PKB një ndikim të veçantë”.⁷⁵ Ndërsa më 27 mars 1948, Stalini i kishte dërguar Titos letrën e parë akuzuese në emër të KQ PKBS. Në këtë kuptim do të ishte karshillëk për Titon që në rrethanat e krijuara të shpallje federatën me Shqipërinë. Por krahas këtyre zhvillimeve, në mbledhjen e 1 marsit të Byrosë Politike të PKJ ishte vendosur gjithashtu që pozitat jugosllave

⁷¹ *AQSh/AP*, viti 1948, dos. 65. Mbledhja e Byrosë Politike të PKSh, më 14 mars 1948.

⁷² *Po aty*.

⁷³ *Marrëdhëniet shqiptaro jugosllave ...*, f.415-417.

⁷⁴ *AQSh/AP*, viti 1948, dos. 70. Mbledhja e Byrosë Politike të PKSh.

⁷⁵ Leonid Gibianskii, *Novaja novejschaja istorija*, Moskva: 1996, mart-aprel, No. 2. f. 160. “Kominform v dejstvii, 1947-1948 gg. Po arhivnim documentam”.

në Shqipëri të ruheshin dhe të mbroheshin.⁷⁶ Prandaj S. Zllatic i bëri me dije E. Hoxhës edhe mendimin e udhëheqjes jugosllave se kushtet për krijimin e federatës me Shqipërinë ishin më të “afërta”. Sipas tij, “marrëdhëniet midis dy vendeve kishin shkuar më përpara se sa protokollet në fuqi”, prandaj ai propozoi që “të gjejmë disa forma që mund të përshtaten e që mund të ndihmojnë në bashkëpunim... Këto më vonë mund t’i hedhim në protokolle zyrtare”.⁷⁷ Kjo do të thoshte se përgjigja jugosllave për federatën me Shqipërinë ishte vetëm përkohësisht mohuese. Drejtuesit shqiptarë të painformuar plotësisht nga Beogradi dhe nga Kremli, u pajtuan me propozimet e S. Zllaticit dhe vendosën që “të punonin si federatë, pa qenë kjo e publikuar”.⁷⁸ Vetë E. Hoxha, që akoma ishte nën impresionet e rezolutës së Plenumit VIII të KQ PKSH, që sapo e kishte firmosur, porositi: “derisa të mos kemi përfunduar gjë, të mos u themi asgjë sovjetikëve”.⁷⁹ Shqiptarët hezituan t’u hapeshin edhe jugosllavëve, ashtu edhe sovjetikëve, megjithëse Çuvahini, pas informacionit të divizionit, u kishte kërkuar ta njoftonin dhe për çdo problem tjetër.⁸⁰ Udhëheqësit shqiptarë ndjeheshin ende të papërgatitur dhe krejt të pasigurt, për të diskutuar hapur e për të hedhur nënshkrimin e tyre në një akt bashkimi federativ me Jugosllavinë. Josip Gjergjia, ambasadori jugosllav në Tiranë, u shkruante eprorëve të tij në KQ PKJ: “Pa diskutim, çështja e Federatës për udhëheqjen e këtushme përfaqëson një llahtar të vërtetë.... Ideologjikisht dhe politikisht shumë të papjekur, të pashkëputur nga pikëpamja e shtetit komb, ata reagojnë në mënyrë të pakuptueshme...”⁸¹

Në të vërtetë ideja e federatës nuk ishte një ide e re për udhëheqjen komuniste shqiptare. Që në vitet e LNÇI, ideja e federatës komuniste ishte bërë pjesë e propagandës së partive komuniste në vendet ballkanike, madje ishin ndërmarrë edhe hapa konkretë në mbështetje të saj. Në frymën e mirëkuptimit e të bashkëpunimit të përgjithshëm të luftës kundër fashizmit, ideja e federatës u duk joshëse, bashkuese dhe integruese. Tek popujt e vegjël të Ballkanit ajo u përjetua si një siguri e shtuar dhe e garantuar për interesat e tyre kombëtare. Në Deklaratën e Kongresit të Këshillit Nacionalçlirimtar në Përmet, më 24 maj

⁷⁶ *Po aty*.

⁷⁷ *Po aty*, viti 1948, dos. 70. Mbledhje e Byrosë Politike të PKSh, më 30 mars 1948.

⁷⁸ *Po aty*.

⁷⁹ *Po aty*.

⁸⁰ *Po aty*, viti 1948, dos. 73. Në muajt janar-shkurt 1948, në Tiranë vjen vetë Petrovi (Mancha), gjë që tregon për një interes të shtuar sovjetik për zhvillimet në Shqipëri. Çuvahini do t’u kërkonte udhëheqësve shqiptarë ta njoftonin për çdo zhvillim në lidhje me divizionin jugosllav që do të vinte në Korçë, si dhe për çdo problem tjetër. Kurse Zhdanovi i kishte thënë E. Hoxhës “Mos na harroni”.

⁸¹ Branko Petranović, *Balkanska Federacija 1943-1948*, Beograd: 1991, f. 155.

1944, deklarohej: “Lufta e popullit shqiptar është e lidhur ngushtë me luftën e gjithë popujve antifashistë. Ajo e vëllazëron popullin tonë me gjithë popujt e tjerë liridashës dhe veçanërisht me popujt fqinjë të Ballkanit. Ajo krijon kondita për krijimin e një konfederate ballkanike, ku të gjithë popujt të kenë të drejta të barabarta, ku të gjithë popujt të kenë mundësi e të zhvillohen në të gjitha fushat...”⁸²

Por ndryshe e përjetonte idenë e federatës ballkanike udhëheqja komuniste jugosllave. Ashtu si shtabin ballkanik në vitet e Luftës Dytë Botërore, në vitin 1943, edhe federatën ballkanike ajo e konsideronte një strukturë politike të udhëhequr vetëm prej saj. Në Plenumin II të KQ PKS, mbledhur në Berat më 23-27 nëntor 1944, i deleguari i KQ PKJ, V. Stojnić, ndërmjet të tjerash, kishte thënë: “Kryesorja është perspektiva e marrëdhënieve me Jugosllavinë. Në këto marrëdhënie ju do të ndërtoni perspektivën tuaj. Perspektiva e Jugosllavisë është perspektiva e krejt Ballkanit, e krejt Evropës Jugore e Perëndimore, ku partitë komuniste nuk janë në pozita komanduese. Ju jeni të vegjël, jeni kafshatë e mirë për imperializmin. Pa Jugosllavinë ju nuk mund ta mbani pushtetin, sidomos pa një Jugosllavi të tillë, siç është sot... Le të jenë këto marrëdhënie një konfederatë edhe më tutje.”⁸³ Në atë fjalim, delegati jugosllav jo pa qëllim e vuri udhëheqjen komuniste shqiptare përpara dy alternativave të paracaktuara: ose Shqipëria të bëhej një kafshatë për imperialistët ose të hynte në (con)federatën jugosllave. Shqiptarët duhej të “ndërgjegjësoheshin” për dobësinë e tyre dhe duhej ta kërkonin vetë bashkimin. Raportin e ndërvarur të Shqipërisë nga Jugosllavia në federatën e përbashkët, vite më vonë do ta pranonte edhe M. Gjilasi: “Mendoj se në instancën e fundit, qëllimet e tilla edhe kanë ekzistuar, pra që Shqipëria t’i bashkohet Jugosllavisë, por me kushtet të cilat pastaj ne do t’i diktonim”.⁸⁴

Traktati i Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Ndihmës Reciproke, si dhe të gjithë marrëveshjet e nënshkruara pas luftës ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, çonin drejt përfshirjes së Shqipërisë në Jugosllavi. Por as bashkëpunimi gjatë Luftës dhe as ai i pasluftës midis PKS dhe PKJ nuk kishte arritur t’i zgjidhte problemet historike të trashëguara mes dy popujve. Ato thjesht ishin mbuluar dhe fshehur. Kështu, me kohë, sa më shumë i mëshohej idesë së federatës me Jugosllavinë (më saktë, nën Jugosllavi) pas luftës, aq më

⁸² *Kongresi I Antifashist Nacional-Çlirimtar*. Botuar prej Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar, 1944, f. 33. Në botimet e mëvonshme të Deklaratës së Kongresit të Përmetit pasazhi për federatën ballkanike nuk është përmendur.

⁸³ *Politikë Antikombëtare e Enver Hoxhës, Plenumi i 2-të i KQ të PKS, Berat, 23-27 nëntor 1944*. Përgatitur për botim nga Ndreçi Plasari dhe Luan Malltezi, Tiranë: 1995, f. 147.

⁸⁴ Agim Zogaj, *Fuqia e ideve*, NSHBI “Zeri”, 1993, f. 29. Intervistë e dhënë nga Milovan Gjilasi, në shkurt të vitit 1991.

tepër kjo ide vihej vetiu përballë ndërgjegjes kombëtare, për të cilën shqiptarët kishin investuar shumë jo vetëm gjatë viteve të LIIB, por gjatë gjithë historisë së tyre. Prandaj shkak për dilemat e udhëheqjes shqiptare ndaj propozimeve jugosllave për të përshpejtuar veprimet dhe kërkesën për federatën ishte ajo që nuk thuhej ose që thuhej nën zë: *frika nga një zgjim i natyrshëm i nacionalizmit shqiptar dhe i reagimit popullor*. Mendoj se E. Hoxha duhet ta ketë ndërë që ai kishte shkuar mjaft larg me politikat e tij komuniste dhe se i kishte rënë mbështetja e muajve të parë të pasluftës, që ai gëzonte në popull. Në vitin 1948, bilanci politik i qeverisë shqiptare mund të përmblihet në: ndërprerje e marrëdhënieve diplomatike me SHBA dhe me Britaninë e Madhe; pozicionim i hapur në mbështetje të BS; goditje e kundërshtarëve politikë brenda vendit duke i identifikuar ata si kriminelë lufte e tradhtarë të atdheut e të popullit; propagandë e gënjeshtërt dhe servile se “pa Jugosllavinë populli ynë nuk do të kishte pavarësi dhe liri” dhe jugosllavizim i jetës shqiptare në të gjitha fushat. Ky bilanc i vitit 1948, katër vjet pas çlirimit nga pushtuesit nazifashistë, e vinte përsëri në pikëpyetje pavarësinë e Shqipërisë, kur historikisht pavarësia kishte qenë qëllimi i jetës individuale e kolektive të shqiptarëve. Në qoftë se përgjigja e udhëheqjes komuniste shqiptare për tezat jugosllave të bashkimit nuk ishte as po e as jo, kjo dëshmon se afrimi ideologjik dhe politik i PKSh dhe PKJ ishte i pamjaftueshëm për t’ia parashtruar hapur popullit shqiptar dhe për të përballuar gjithë sa do të ndodhte në Shqipëri në rastin e një bashkimi jugosllav-shqiptar. Por, ajo çka nuk guxojnë ta thonë hapur udhëheqësit shqiptarë dhe nuk pasqyrohet në dokumentet e kohës të PKSh, është shumë qartë e shprehur në rekordet e diplomacisë amerikane që në vitin 1945, e cila parashikonte se “Populli shqiptar ka shumë dëshirë të ketë pavarësi kombëtare, sepse ata nuk e quajnë veten as sllavë, as bullgarë, as maqedonas e as grekë. Çdo përpjekje që mund të bëhet për federimin e tyre me jugosllavët ose me njësi të tjera politike do të ndeshet me rezistencë dhe shoqërohet me gjakderdhje”⁸⁵. Në të vërtetë kësaj ia kishte frikën edhe E. Hoxha. Informacioni që ai kishte nga organet e Sigurimit të shtetit flisnin për pakënaqësinë e shqiptarëve ndaj konventës ekonomike dhe marrëveshjeve të shumta shqiptaro-jugosllave. Nacionalizimi shqiptar në vitet e LIIB doli triumfues në Shqipëri dhe pavarësisht se ai kaloi dhe u menaxhua nga PKSh si një nacionalizëm antifashist, nuk ishte e lehtë që të shlyhej kollaj në kushtet e reja.

Është interesante të vërejmë se sa më e ndikueshme bëhej udhëheqja shqiptare, aq më ekstravagantë me kërkesat e tyre bëheshin drejtuesit e Beogradit. Në një hark të shkurtër kohe, në muajt e parë të vitit 1948 dhe sidomos pas Plenumit VIII, ka një varg veprimesh të koordinuara ekonomike,

⁸⁵ *Foreign Relations of the United States, Diplomatic Papers, 1945, Volume IV, Europe, Washington: 1963, 875.01/7-145, Telegram Nr. 57. Përfaqësuesi në Shqipëri Jacobs ia dërgon Sekretarit të Shtetit.*

ushtarake e politike nga pala jugosllave për të realizuar federatën. Tito, nëpërmjet ambasadorit të tij në Moskë, Vladimir Popoviç, kërkoi nga sovjetikët miratimin për heqjen e specialistëve sovjetikë nga Shqipëria dhe për forcimin atje të rolit kryesor të Jugosllavisë.⁸⁶ Në Shqipëri, Savo Zllatiç bënte presion mbi drejtuesit shqiptarë për realizimin e kësaj kërkese. Ai e shtroi këtë çështje hapur duke deklaruar se nuk mund të punohej me dy lloj këshilltarësh: “Këshilltarët jugosllavë nuk mund të punojnë me sovjetikët. Prandaj nëse ju doni një bashkëpunim të ngushtë ekonomik me Jugosllavinë, duhen braktisur këshilltarët sovjetikë. Ju mund të mbani inxhinierët dhe teknikët e thjeshtë, të cilët do të zbatojnë çdo gjë që do t’u themi ne”.⁸⁷ Nuk mbahet në punë një sahat me tri lloje veglash, aludonin ata për ushtrinë shqiptare ku, sipas tyre kishte një përzjerje udhëzimesh e rregulloresh sovjetike, italiane e jugosllave.⁸⁸ Më në fund, edhe ky hap u hodh, ashtu si e deshën jugosllavët. Vendimi se këshilltarët sovjetikë nuk ishin të nevojshëm iu komunikua përfaqësuesve të qeverisë sovjetike⁸⁹ diku nga fillimi i prillit. Ky veprim zgjoi reagimin e Moskës. Ambasadori sovjetik në Tiranë i komunikoi Hoxhës vendimin e qeverisë së tij për të tërhequr nga Shqipëria jo vetëm këshilltarët, por edhe të gjithë specialistët civilë dhe ushtarakë.⁹⁰ Ishte i njëjti veprim si ai me jugosllavët, më 18 mars. I njëjtë ishte edhe motivi, që sovjetikët e thanë qartë: “lidhja me jugosllavët”.⁹¹

Traktati i koordinimit të planeve ekonomike, bashkimit të doganave dhe barazimit të monedhës, i nënshkruar më 27 dhjetor 1946, e ktheu ekonominë e Shqipërisë në një shtojcë ekskluzive të ekonomisë jugosllave. Komisioni i Koordinimit që u krijua për zbatimin e këtij traktati, të akordeve për shoqëritë e përbashkëta dhe të gjitha marrëveshjeve ekonomike shqiptaro-jugosllave, u kthye në një qeveri të dytë, pasi kryetari i tij, Sergej Krajger filloi të urdhëronte dhe të thërriste në raport ministrat shqiptarë, të kërkonte drejtimin e minierave dhe të industrisë, ndërsa qeverisë shqiptare t’i linte drejtimin e sektorëve të tjerë të dorës së dytë etj. Komisioni i Koordinimit i shkëputi shoqëritë krejtësisht nga drejtimi i ministrive shqiptare, i përjashtoi ato nga të gjitha ligjet financiare shqiptare dhe nga çdo kontroll i shtetit shqiptar. Kështu që shoqëritë e përbashkëta pothuajse u kthyen në ndërmarrje ekonomike jugosllave ose në ndërmarrje federative, siç u thoshin jugosllavët. Të gjitha këto praktika

⁸⁶ Leonid Gibianskii, *The Reseach Support Scheme of the open Society Institute. Grant 941/94*. “Ot pervovo ko vtoromu sovjeshaniju Kominforma”.

⁸⁷ *AQSh/AP*, viti 1948, dos. 11. Shënime për veprimtarinë e Savo Zllatiçit në Shqipëri.

⁸⁸ *Po aty*, dos. 70, Strukturë.

⁸⁹ *Po aty*, OU, viti 1948, dos. 87.

⁹⁰ *AQSh*, Fondi 490, viti 1948, dos. 849.

⁹¹ *AQSh/AP*, OU, viti 1948, dos. 80.

karakterizoheshin nga një mungesë e theksuar reciprociteti. U intensifikuan akuzat se shqiptarët kanë frikë, janë skeptikë, planet po vonohen e nuk po realizohen etj. Ndërkohë ushtarakët jugosllavë në Shqipëri bënin propagandë se “ushtria shqiptare nuk mund të rezistojë, se ne jemi përgjegjës për këtë situatë, pasi BS është larg, se ai mund të bëjë lëshime e të sakrifikojë Shqipërinë si Iranin etj.”. Thërriteshin në Beograd anëtarë të Byrosë Politike, si Kristo Themelko dhe ushtarakë të lartë si Beqir Balluku dhe përpunoheshin në takime me personalitete ushtarake dhe politike, madje dhe me Titon, për të qenë zëdhënës të kërkesave jugosllave.⁹²

Ndërkohë që këto veprimtari diktuese ishin në kulmin e tyre, më 10 prill 1948, S. Zllatiç i dorëzoi E. Hoxhës “Teza” të reja për bashkimin federativ.⁹³ Sipas tyre, Shqipëria dhe Jugosllavia duhej të kishin një plan ekonomik, një qëndrim të përbashkët karshi vendeve të treta, një sistem të përbashkët në legjislacion, financë, tregti, kufij, pasaporta, arsim etj. Do të kishte një Komitet në Tiranë dhe një Komitet në Beograd dhe qeveritë një pjesë të punëve të tyre do t’ia transferonin këtij Komiteti. Këto gjëra do të vendoseshin në një Protokoll, që do të shërbente edhe si një akt ndërkombëtar midis dy shteteve. Hapi i mëtejshëm do të ishte federata.⁹⁴ S. Zllatiçi kërkoi që Tezat e tij të analizoheshin dhe miratoheshin në Byronë Politike të PKSh me urgjencë, pasi më 18-19 prill do të ishte në mbledhjen e Skupshtinës (Kuvendit) jugosllave!⁹⁵ Jugosllavët kishin nevojë të kishin një dokument të nënshkruar nga pala shqiptare, ku të kërkohej e të pranohej bashkimi federativ me Jugosllavinë. Letra e 17 marsit e E. Hoxhës nuk ua kishte plotësuar këtë synim. Pakënaqësinë e tyre për mosparaqitjen e kërkesës për bashkimin federativ të Shqipërisë me Jugosllavinë në letrën e lartpërmendur, S. Zllatiçi e M. Kupreshanin ia kishin shprehur hapur Kristo Themelkos, në Beograd, në fund të marsit 1948.⁹⁶

Heqja dorë e jugosllavëve nga propozimet e paraqitura për divizionin dhe federatën, duhet t’i ketë krijuar përshtypjen E. Hoxhës se Tito në Beograd dhe përfaqësuesit e tij në Tiranë ndjeheshin të sforcuar në veprimet e tyre ndaj Shqipërisë. Prandaj sa më shumë avanconin me kërkesa të mëtejshme jugosllavët, aq më refraktarë e dyshues në përgjigje bëheshin shqiptarët.

⁹² *Po aty*, viti 1948, dos. 82. Pohimet e Kristo Themelkos në mbledhjen e Byrosë Politike, më 25 prill 1948.

⁹³ Tezat e para për Federatën, S. Zllatiç ia kishte dorëzuar B Politike të PKSh më 5 dhjetor 1947.

⁹⁴ *AQSh/AP*, Marrëdhëniet e PKSh me PKJ, viti 1948, dos. 5. Tezat e reja të Savo Zllatiç lidhur me propozimet e KQ PKJ, më 10 prill 1948.

⁹⁵ *Po aty*, Marrëdhëniet e PKSh me PKJ, viti 1948, dos. 4. Në këtë datë S. Zllatiç ka relatuar për Shqipërinë në Byronë Politike të PKJ.

⁹⁶ *Po aty*, viti 1948, dos. 82. Takimi i S. Zllatiçit, M. Kupreshanit, R. Hamoviçit, V. Tempos, K. Popoviçit në Beograd, në fund të marsit 1948.

Pavarësisht nga vendimi i marrë në mbledhjen e Byrosë Politike në fund të marsit për të mos informuar sovjetikët, E.Hoxha, më 10 mars 1948, atë ditë kur S. Zllatiç dorëzoi Tezat e reja për federatën, mblodhi anëtarët e Byrosë dhe hapi mbledhjen me këto fjalë: “Ne vumë në dijeni qeverinë sovjetike për ato që kemi bërë me jugosllavët” dhe shprehu mendimin se kështu duhej të vepronin edhe në të ardhmen.⁹⁷ Që nga ky moment E. Hoxha do të mbante lidhje të afërta me sovjetikët, të cilët do ta informonin atë dhe për krizën që kishte lindur midis Moskës e Beogradit. Ai i kërkoi Çuvahinit që “specialistët sovjetikë të mos largohen nga Shqipëria” dhe me porosi të këtij të fundit ia parashtrio këtë kërkesë edhe Molotovit në një “letër të veçantë”.⁹⁸ Më 12 prill, Byroja Politike e PKSh mori në analizë tezat e S. Zllatiçit të dorëzuara dy ditë më parë. Në kundërshtim me prezantimin paraprak të tezave nga S. Zllatiç, se ato synonin gjetjen e “formave të reja” që do të forconin bashkëpunimin, E. Hoxha orientoi pjesëmarrësit e mbledhjes se problemi “kishte karakter politik”, se nuk ishte “çështje formash, por format duheshin nesër si bazë”.⁹⁹ Për rëndësinë e çështjes, tezat e S. Zllatiç u konsideruan nga anëtarët e Byrosë si “të shpejtuara” dhe se duhej kohë për të marrë vendime. Pikërisht në këtë shtjellë diskutimesh, ndodhi e papritura. Më 15 prill, gjenerali M. Kupreshanin, pasi kishte sjellë disa fakte të veçuara për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në përgjithësi, u komunikoi gjeneralëve Beqir Balluku¹⁰⁰ dhe Kristo Themelko¹⁰¹ se “Marrëdhëniet tona në Ushtri nuk mund të ecin më... Ju lutem, vini në korrent E. Hoxhën”.¹⁰² Disa ditë më vonë, më 20 prill, ai i parashtrio Shtatmadhorisë shqiptare një urdhër të eprorëve të tij se “brenda tri ditëve të gjithë instruktorët dhe delegatët ushtarakë jugosllavë, që ndodheshin pranë Ushtrisë shqiptare, duhej të largoheshin nga Shqipëria”.¹⁰³ I paduruar u tregua dhe S. Zllatiçi për Tezat e tij. Duke sajuar një shkak banal, ai i deklaroi K. Xoxes dhe Tuk Jakovës,¹⁰⁴ më 20 prill, se “Kanë kaluar 20 ditë dhe unë shkoj pa përgjigje... Këtu ka situatë të re... Janë simptomat e një fryme që po zhvillohet... Unë i tërheq propozimet e bëra. Nuk ekzistojnë më propozimet e KQ PKJ për një afrim të mëtejshëm”.¹⁰⁵

⁹⁷ *Po aty*, dos. 73. Mbledhja e Byrosë Politike të PKSh, më 10 prill 1948.

⁹⁸ *Po aty*, dos. 74.

⁹⁹ *Po aty*, dos. 74. Mbledhje e Byrosë Politike të PKSh, më 12 prill 1948.

¹⁰⁰ Beqir Balluku ishte Shef i Shtatmadhorisë së Ushtrisë Shqiptare.

¹⁰¹ Kristo Themelko ishte Drejtor i Drejtorisë Politike në Ushtri.

¹⁰² *AQSh/AP*, Marrëdhëniet e PKSh me PKJ, viti 1948, dos. 5.

¹⁰³ *Po aty*, dos. 78. Mbledhja e Byrosë Politike të PKSh, më 20 prill 1948.

¹⁰⁴ Tuk Jakova ishte anëtar i Byrosë Politike të PKSh.

¹⁰⁵ *AQSh/AP*, viti 1948, dos. 78. Mbledhja e Byrosë Politike të PKSh, më 20 prill

Këto reagime të papritura të jugosllavëve mund të merren ose si prekje pulsi nëse ishte njohur pala shqiptare me konfliktin sovjeto-jugosllav, ose edhe si provokim, për të parë si do të reagoonte ajo më tej. E. Hoxha i refuzoi akuzat e M. Kupreshaninit dhe të S. Zllatiçit duke i shkruar Titos dy letra të njëpasnjëshme. Në letrën e parë më 18 prill 1948, E. Hoxha, pasi fliste për disa incidente të shkëputura me jugosllavët që gjendeshin në Tiranë, e garantonte Titon se “në marrëdhëniet tona të gjithanshme nuk ekziston asnjë re”,¹⁰⁶ ndërsa në letrën e dytë, më 21 prill 1948, ai i lutej Mareshalit ta shqyrtonte dhe ta prapësonte urdhrin për tërheqjen e instruktorëve dhe këshilltarëve ushtarakë nga Shqipëria.¹⁰⁷ Siç shihet në të dy letrat, E. Hoxha vazhdoi të luante lojën e tij të besnikërisë ndaj Titos, PKJ dhe të bënte të paditurin për thyerjen sovjeto-jugosllave. Por ishte e kotë, përgjigja e Titos ishte e prerë. Në letrën e tij dërguar E. Hoxhës më 22 prill, Tito konstatonte se marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve “po keqësoheshin”, se incidentet e shumta “maskojnë arsye më të thella”, se tek udhëheqja shqiptare nuk ka vlerësim për “saktifikat ekonomike” që po bën populli jugosllav, dhe se në të ardhmen “nuk do të ketë as ndihma e subvencione” për Shqipërinë, por çdo gjë do të vendoset mbi baza shtetërore reciproke.¹⁰⁸ Kurse në letrën e dytë të shkruar po atë ditë, Tito theksonte se një nga shkaqet kryesore për përkeqësimin e marrëdhënieve “është mosbesimi kundrejt nesh nga ana e një pjese të udhëheqësve shqiptarë”.¹⁰⁹

5. Shqipëria pas letrave sovjetike

Është interesante të vëresh si u pritën letrat e Stalinit dhe Rezolucioni i IB nga udhëheqja shqiptare dhe si u menaxhuan ato nga E. Hoxha. Më 23 prill 1948, në Byronë Politike të PKSh, mbërriti *Letra e parë* e KQ PKBS dërguar KQ PKJ, më 27 mars 1948. Në mbledhjen e organizuar me këtë rast, E. Hoxha i informoi anëtarët e Byrosë për përmbajtjen e Letrës, ndërsa për vete la të kuptohej se ishte vënë në dijeni më parë dhe kishte pasur kujdes “të mbante situatën në Byro dhe sidomos Kristo Themelkon që të mos bënte më shumë gabime”.¹¹⁰ Ato çka thuheshin në Letër shokuan anëtarët e Byrosë. Dy ditë më vonë, letra u diskutua në Byronë Politike, por anëtarët e saj ende nuk e merrnin me mend se sa e thellë ishte thyerja midis Stalinit e Titos. Ata u treguan

¹⁰⁶ *Po aty*, Marrëdhëniet e PKSh me PKJ, dos. 4. Letër e E. Hoxhës dërguar Titos më 18 prill 1948.

¹⁰⁷ *Po aty*, Marrëdhëniet e PKSh me PKJ, dos. 4. Letër e E. Hoxhës dërguar Titos, më 21 prill 1948.

¹⁰⁸ *Po aty*, Marrëdhëniet e PKSh me PKJ, dos. 4. Letër e Titos dërguar E. Hoxhës më 22 prill 1948.

¹⁰⁹ *Po aty*.

¹¹⁰ *Po aty*, dos. 80. Mbledhja e Byrosë Politike të PKSh, më 23 prill 1948.

mbështetës ndaj BS,¹¹¹ por edhe të kujdesshëm duke shfaqur besim se “udhëheqja e PKJ do ta kuptonte kritikën dhe do të mundohej ta vinte në zbatim, ashtu siç këshillonte Partia Bolshevike”.¹¹² Në diskutimin e *Letrës së dytë* të Stalinit, anëtarët e Byrosë ishin më të avancuar. Ata e konsideruan qëndrimin e PKJ si “jashtëzakonisht të rrezikshëm” dhe që përfaqëson një “tradhti ndaj BS e ndaj kampit”. Në të njëjtën kohë u shpreh frika se për shkak të lidhjeve të shumëfishta me PKJ edhe “gjendja në PKSh ishte shumë alarmante”, pasi karakterizohej nga të njëjtat gabime, si gjysmë ilegaliteti, mungesa e demokracisë, kooptimet në KQ etj. Gjithashtu diskutuesit shfaqën hapur shqetësimin për marrëdhëniet midis PKSh dhe PKJ në të ardhmen. Vetë E. Hoxha u tregua i gatshëm që t’i ofronte ndihmë Informbyrosë duke i vënë në dispozicion të gjitha dokumentet e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave.¹¹³ Me këtë rast ai kërkoi rishikimin e Plenumit të Beratit, ku për të pati kritika të shumta nga anëtarët e Komitetit Qendror, që në mënyrë të tërthortë u mbështetën nga i deleguari jugosllav, V. Stojnić.¹¹⁴ Kjo kërkesë e E. Hoxhës do të thoshte të laheshin disa llogari të vjetra me ata që e kishin kritikuar atë në Plenum. Në diskutimin e *Letrës së tretë* të KQ PKBS, konstatojmë se akuzat sovjetike u pranuan nga të gjithë anëtarët e Byrosë Politike të PKSh, por ata ende nuk ishin gati të merrnin përgjegjësitë e luftës së hapur kundër udhëheqësve “armiq” jugosllavë. Pati mendime që të mbahej një “qëndrim provizor” ndaj Jugosllavisë, derisa “të vinin konkluzionet e Kominformit”. Në dallim nga ata, E. Hoxha u tregua i vendosur, pa asnjë lëkundje në qëndrimin kundër udhëheqjes jugosllave, përndryshe sipas tij “do të kishin komplikacione”. Ai theksoi se duhej të luftonin për të bindur BS se jugosllavët “na kanë gënjyer”, se duhet parë problemi i kuadrove, se “ata që janë për gjyq të shkojnë në gjyq”, se “kemi goditur Nako Spirun dhe Mehmet Shehun pa të

¹¹¹ *Po aty*, dos. 82, fl. 60. E Hoxha në mbledhjen e Byrosë Politike, më 25 prill 1948, thekson: “Ne duhet të kemi kujdes çështjen e BS, duhet ta ngremë në formë të dhjetëfishuar, ta vëmë në radhë të parë.”

¹¹² *Po aty*.

¹¹³ *Po aty*, dos.87. Letra e dytë e KQ PKBS dërguar KQ PKJ u diskutua në Byronë Politike të PKSh më 13 maj 1948. Tuk Jakova, një nga anëtarët e Byrosë, në atë mbledhje do të shprehej: “Kemi bërë gjithë këtë punë lidhur me marrëdhëniet shqiptare-jugosllave, kemi zhvilluar në Partinë tonë dhe në popullin tonë anën pozitive dhe tashti jemi në pozita kritike. Për t’i prishur është lehtë, por për t’i rregulluar është zor kur i prish”

¹¹⁴ Plenumi i II i KQ PKSh i mbajtur në Berat, më 23-27 nëntor 1944, ishte ngjarja në të cilën jugosllavët nxitën kritikën ndaj gabimeve të PKSh dhe E. Hoxhës gjatë LANÇ për të evidencuar dhe lançuar Titon dhe PKJ në Shqipëri dhe Ballkan.

drejtë..., kur ata bashkëpunonin me sovjetikët” etj. Dhe ndërkohë porositi që “Byroja të qëndronte radhështrenguar” në këto momente.¹¹⁵

Ishte një moment kthese vendimtare dhe E. Hoxha po luante fort. Në ndryshim nga Plenumi II në Berat (1944) dhe Plenumi VIII (1948), ku E. Hoxhës i ishte dashur të bënte autokritikë për t’i shpëtuar goditjes, në diskutimin e Letrave të Partisë Bolshevike, ai u tregua i vendosur për të rikuperuar statusin e tij të dobësuar si sekretar i PKSh. Në ndryshim nga mendimi që kishin krijuar jugosllavët për të se karakterizohej nga “disa tipare të një intelektual mikroborgjez”,¹¹⁶ ai u përpoq të dëshmonte vendosmëri e besnikëri ndaj udhëheqjes sovjetike. Akoma më tej, ai u tregua i pamëshirshëm ndaj atyre që e kishin kundërshtuar, duke kombinuar me mjeshtëri propagandën demagogjike dhe goditjet përjashtuese. E. Hoxha ishte futur shumë thellë në lojën e patronazhit jugosllav dhe vetëm një sjellje e tillë mund t’i siguronte qëndrimin e mëtejshëm në pushtet.

Të deleguarit jugosllavë, të cilët morën pjesë në momentin e themelimit të PKSh, u imponuan duke larguar nga udhëheqja e partisë kryetarët e grupeve komuniste, disa prej të cilëve ishin të dërguar të Kominternit, duke vendosur anëtarë të rinj¹¹⁷ që i formësuan sipas shembullit të PKJ. Të deleguarit jugosllavë ishin ata që krijonin listat e anëtarëve të KQ të PKSh që nga krijimi i PKSh e deri në fund të LANÇI.¹¹⁸ Një nga ata që u promovua ishte dhe E. Hoxha. M. Popoviçi, i deleguari i parë jugosllav pranë KQ PKSh, e ndihmoi E. Hoxhën të bëhej një kryetar partie me autoritet, ndërsa të deleguarit e mëvonshëm të PKJ¹¹⁹, nuk ndoqën këtë rrugë. Në lojën e tyre për të pasur një udhëheqje të bindur të PKSh, ata i përdorën udhëheqësit shqiptarë njëri pas tjetrit: N. Spirun, K. Xoxen, K. Themelkon, por edhe E. Hoxhën. Ata bënë një politikë diferencuese ndaj anëtarëve të Byrosë Politike të PKSh, gjë që shkaktoi

¹¹⁵ *AQSh/AP*, viti 1948, dos. 93. Letra e Tretë e KQ PKBS dërguar KQ PKJ u diskutua në Byronë Politike të PKSh, më 25 maj 1948.

¹¹⁶ *Po aty*, dos. 93. Këto janë shprehje të përmendura në mbledhjen e Byrosë nga E. Hoxha, sipas një letre që E. Kardeli i kishte dërguar Stalinit, në prill të vitit 1947.

¹¹⁷ Ndërsa udhëheqësit e partive të tjera komuniste të Evropës ishin trajnuar në BS, udhëheqësit e PKSh e kanë zanafillën e tyre në ditën e krijimit të PKSh (nëntor 1944) dhe më vonë gjatë luftës antifashiste nacionalçlirimtare. Ilegaliteti i thellë në të cilin u krijua PKSh u shtua edhe më shumë gjatë viteve të luftës, kur përballë qëndronte një armik i egër. Ky ilegalitet u trashëguua edhe në vitet e pasluftës. Këtu qëndron dhe një nga karakteristikat e udhëheqësve të PKSh.

¹¹⁸ I deleguari i KQ PKJ pranë PKSh, Miladin Popoviçi, ishte ai që në momentin e formimit të PKSh, në nëntor 1941, hartoi dhe krijoi listën e KQ provizor të PKSh. Të njëjtën gjë bëri ai edhe në Konferencën e PKSh në Labinot, në mars 1943, kur u formua KQ i përhershëm i PKSh.

¹¹⁹ Të deleguarit e mëvonshëm të PKJ në Shqipëri, pas M. Popoviçit ishin: Velimir Stojnić, Josip Gjergjia e Savo Zllatiç.

gërryerje në unitetin e udhëheqjes së PKSh dhe njëkohësisht një lloj inferioriteti individual dhe kolektiv ndaj jugosllavëve. E gjithë udhëheqja e PKSh dukej sikur ishte në provë. Me kohë u përpunua e u përforcua bindja se vetëm mbështetja te jugosllavët siguronte një pozitë të sigurt në Parti e në shtet. Jo rrallë, duke mbështetur herë N. Spirun e herë K. Xoxen, ata anashkalonin E. Hoxhën ose i bënin atij kritika të nënkuptuara si përgjegjësi kryesor i PKSh. Megjithatë ata asnjëherë nuk kanë propozuar ose kërkuar largimin e E. Hoxhës nga posti i sekretarit të Përgjithshëm të PKSh. Përkundrazi kanë këmbëngulur që ai të qëndrojë¹²⁰. Dhe kjo mendojmë se ka disa arsye: *Së pari*, E. Hoxha, atëherë ishte sekretar i përgjithshëm partie, komandant i forcave të armatosura dhe kryetar i qeverisë provizore. Largimi i tij do të ishte një hap i pamenduar mirë. Për këtë me siguri do të njoftohej edhe Moskë që kishte një mision ushtarak sovjetik pranë Shtabit NÇI të Shqipërisë, gjë që mund të sillte telashe. *Së dyti*, mbetja e E. Hoxhës si sekretar i kritikuar e i dobët, jugosllavëve më shumë u ndreqte punë se sa u prishte. Ata mund ta kushtëzonin pozitën e tij si sekretar i parë me lëshime të mëvonshme. *Së treti*, edhe vetë E. Hoxha u tregua i aftë të manovronte në Plenum dhe në mbledhje të tjera të Byrosë Politike për të ruajtur postin e tij. Ai ishte i ndërgjegjshëm se të deleguarit e KQ PKJ ishin të informuar me hollësi për gjithçka ndodhte brenda udhëheqjes komuniste shqiptare. Prandaj ai u paraprinte situatave, herë duke pranuar të gjitha përgjegjësitë e akuzat e herë duke u bërë palë me të deleguarit e KQ PKJ¹²¹ kundër anëtarëve të tjerë të Byrosë apo shokëve të tij të luftës. Ai asnjëherë nuk i kundërshtoi hapur dhe fort jugosllavët deri në fund. Në sajë të këtij qëndrimi, statusi i E. Hoxhës sado që u dobësua, ai asnjëherë nuk u asgjësua. Gjithsesi, E. Hoxha i konsideroi letrat e Kominformit si shans për të braktisur pozitën e papërshtatshme në të cilën e kishin vënë jugosllavët.

PKSH nuk arriti të bëhej anëtare e Informbyrosë.¹²² Gjatë diskutimit të letrave të Stalinit në Byronë Politike të PKSh, ishte një bindje e përgjithshme

¹²⁰ *AQSh/AP*, viti 1948, dos. 103, fl. 229.

¹²¹ *Po aty*, dos. 53. Në një mbledhje të Byrosë Politike, disa ditë para Plenumit VIII E. Hoxha u shpreh: “Të gjithë sektorët të shkojnë me atë rrugë, me baza federale, duke qenë kështu Sekretar i Përgjithshëm Titoja. Kështu vendi do të shkojë në një Federatë”; *Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse. Dokumente*. Përgatitur nga Islam Lauka dhe Eshref Ymeri, Tiranë: 2006, f. 166. Në takimin me ambasadorin sovjetik Çuvahin, menjëherë pas përfundimit të Plenumit VIII, E. Hoxha u shpreh: “Në Partinë tonë është arritur një unitet i plotë”.

¹²² Agim Zogaj, *Fuqia e ideve*, NSHBI “Zeri” 1993, f. 30. Sipas një interviste të dhënë në shkurt 1991, Milovan Gjilasi pohon se ai dhe E. Kardeli, në mbledhjen themeluese të Kominformit kishin propozuar që në të, të merrte pjesë dhe PKSh, por sovjetikët ishin kategorikisht kundër. Ai pohon se nuk e ka kuptuar kurrë këtë qëndrim të sovjetikëve, por “ndoshta ata kishin parasysh situatën në Greqi dhe frikën se mos në raport me Perëndimin, pozita e Shqipërisë po ndërron”.

se PKSh do të shpërblehej për qëndrimin solidarizues me Partinë Bolshevike dhe se shqiptarët do të ftoheshin në mbledhjen e paralajmëruar të Kominformit, më 20 qershor. Por kur data 20 qershor kaloi dhe asnjë ftesë nuk erdhi, KQ PKSh më 21 qershor i drejtoi një letër Kominformit dhe kërkoi që përfaqësuesit e PKSh të ftoheshin në atë mbledhje, pasi kjo ishte “absolutisht e nevojshme se PKSh kishte qenë shumë pranë PKJ”.¹²³ Pavarësisht se përgjigja ishte negative, udhëheqja e PKSh vazhdoi jo vetëm të shprehë mbështetjen për PKBS, por dhe të angazhohej në radhët e para të fushatës antijugosllave. Komunikata e KQ PKSh për Rezolucionin e Kominformit u vlerësua nga përfaqësuesit e vendeve komuniste si “më e rrepta”, “më e forta”, “më e guximshmja”, e më kategorikja”.¹²⁴ Në bazë të vendimit¹²⁵ të Sekretariatit të Kominformit, të 5 korrikut 1948, PKSh nuk mori pjesë në Kongresin e V të PKJ, megjithëse ishte e ftuar.

Në propagandën masive dhe në mbledhje të organizuara enkas, komunistëve dhe qytetarëve të Shqipërisë iu tha se udhëheqësit jugosllavë “kishin tradhtuar” mësimet e marksizëm-leninizmit, BS dhe kampin demokratik. Fillimisht u punua Rezolucioni i Kominformit. KQ PKSh porosiste komitetet e rretheve që të tregohet kujdes që në mbledhje “të mos ngjallen diskutime akademike”, por edhe të mos ketë “kuriozitate të kota”; mbledhjet duhen bërë në dhoma të vogla me nga “20 vetë dhe të mos zgjasin më shumë se 2 orë”; mbledhjet duhet të ngjallin besimin e madhe te kampi antiimperialist, demokratik me BS në krye.¹²⁶ Ndërsa nga komitet e rretheve vinin relacionet se “nga populli diskutime nuk pat; nuk kanë mbajtur shënime; janë ba pyetje që nuk i kanë të qarta qëllimet e luftës nga ana anglo-amerikanëve; janë ba pëshpëritje vesh më vesh etj”.¹²⁷ E vërteta është se në këto mbledhje, përveç anëtarëve të PKSh, pjesëmarrja e qytetarëve ishte e pakët. E megjithatë pati pyetje që jo rrallëherë të deleguarit e KQ PKSh që kishin shkuar për të dhënë shpjegime në popull, viheshin në pozitë të vështirë. Pyetje të tilla se përse Shqipëria nuk merr pjesë në Kominform, përse jugosllavët quhen trockista, përse anglo-amerikanët duan ta quajnë Kominformin si Komintern, çfarë qëndrimi do të mbajë PKSh në qoftë se jugosllavët insistojnë në pikëpamjet e tyre etj. mbetën pa përgjigje.¹²⁸

Më i vështirë dhe delikat ishte shpjegimi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave. Ajo çka u tha për to pas publikimit të Rezolucionit të Informbyrosë

¹²³ *AQSh/AP*, viti 1948, dos. 5. Marrëdhëniet me PK (b) të BS.

¹²⁴ *AMPJ*, viti 1948, dos. 163. Telegramet e ambasadorit shqiptar në Moskë, Mihal Prifti, dërguar MPJSh.

¹²⁵ *Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse*. Përgatitur nga Islam Lauka dhe Eshref Ymeri, Tiranë: 2006, f.178-179.

¹²⁶ *AQSh/AP*, viti 1948, dos. 296. Strukturë.

¹²⁷ *Po aty*.

¹²⁸ *Po aty*, dos. 70; 70/1; 77; Strukturë.

ishite krejt e kundërta nga ajo çka ishte thënë para daljes së tij, se politika e Jugosllavisë ndaj Shqipërisë ishte një politikë koloniale, se Tito donte të sillte divizionin për të pushtuar Shqipërinë, se E. Hoxha e kishte kundërshtuar ardhjen e divizionit, se N. Spiru nuk ishte armik por viktimë e jugosllavëve dhe se ai i kishte parë drejt marrëdhëniet me Jugosllavinë, se udhëheqësi i Partisë E. Hoxha ishte i mënjanuar, se udhëheqësit jugosllavë donin të zhduknin independencën e Shqipërisë etj. Ajo që u vu re në këto mbledhje të komanduara ishte se të deleguarit e KQ PKSh nuk ishin të përgatitur të përballëshin me të vërtetën. Pyetjeve të tilla, si: pse PKSh ndoqi eksperiencën e PKJ dhe jo të BS, si qëndron tani çështja e Kosovës, pse nuk ndërpresim dhe Traktatin e Miqësisë dhe Ndhmës Reciproke, ashtu siç ndërpreme marrëdhëniet ekonomike me Jugosllavinë, pse E. Hoxha mbeti i izoluar dhe si mund të qëndrojë i izoluar një udhëheqës partie për katër vjet, si i kundërshtoi E. Hoxha planet e jugosllavëve, pse PKSh qëndroi në ilegalitet etj., të deleguarit e KQ nuk iu përgjigjën hapur dhe realisht. Ata flisnin me gjysmë të vërteta, gjë që jo rrallë shkaktonte mosbesim dhe ilaritet te dëgjuesit. Gjithsesi E. Hoxha kërkonte informacion për gjithçka që pyetej e diskutohej në këto mbledhje, si dhe për gjithçka që pëshpëritej jashtë këtyre mbledhjeve.

Sa më shumë mbledhje organizoheshin, aq më shumë dilte në pah trashëgimia jugosllave në funksionimin e PKSh dhe të shtetit shqiptar dhe aq më shumë shtoheshin akuzat për jugosllavët. Por emrat e përveçëm që duhej të mbanin përgjegjësi për gjendjen e krijuar mungonin. Përpara popullit dhe në pritje delegacionesh E. Hoxha, K. Xoxe, P. Kristo, B. Balluku etj. dilnin së bashku. Brenda Byrosë Politike E. Hoxha tregoi i gatshëm të këpuste lidhjet me jugosllavët me çfarëdo çmimi: “Marrëdhëniet tona janë në rrezik sikurse janë për të gjithë Kampin, por në qoftë se nuk të jep bukë Jugosllavia, ta jep BS”¹²⁹ Ndërsa disa anëtarë të tjerë të Byrosë, si K. Xoxe, B. Balluku, G. Nushi, H. Kapo, Xh. Blushi, P. Kristo etj. megjithëse pranonin akuzat e Informbyrosë ndaj Jugosllavisë, sugjeronin një qëndrim më të matur, për shkak të lidhjeve ende në fuqi shqiptaro-jugosllave. Kështu p.sh në një nga mbledhjet e Byrosë Politike në maj të vitit 1948, E. Hoxha mbeti në minorancë në qëndrimin e tij. Refuzimi E. Hoxhës për të mos i dërguar telegram Titos me rastin e përvjetorit të ditëlindjes, me argumentin se “njerëzve që janë kundër Partisë bolshevike, kundër partisë sonë nuk mund t’u dërgojmë telegram”, nuk u pranua nga anëtarët e Byrosë. Ata vendosën që në këtë rast të ndiqnin shembullin e Gj. Dimitrovit dhe prandaj duhej të informoheshin. Kurse rasti i dytë është letra që iu dërgua Titos më 23 maj 1948. Projekti që kishte përgatitur E. Hoxha u “zbut” nga shokët e Byrosë me argumentin se “nuk na lejohet të tregohemi më të ashpër se letra e Partisë bolshevike”.¹³⁰ Dhe për të shprehur unitetin e Byrosë,

¹²⁹ *Po aty*, dos. 87. Mbledhja e Byrosë Politike të PKSh, më 13 maj 1948.

¹³⁰ *Po aty*, dos. 89. Mbledhja e Byrosë Politike të PKSh, më 20 maj 1948.

letra u firmos nga E. Hoxha dhe K. Xoxe.¹³¹ Në këtë rast E. Hoxha i akuzoi ata se “nuk i kishin kuptuar letrat e Partisë Bolshevike” dhe informoi ambasadorin sovjetik, Çuvahin për gjithçka kishte ndodhur.¹³² Siç duket, në Byronë Politike ishte vështirë të akuzoje ndonjë anëtar, pasi kush më shumë e kush më pak, të gjithë i kishin pranuar pa asnjë kundërshtim pikëpamjet, format, këshillimet, diktimet dhe patronazhin e udhëheqësve jugosllavë. Nga qershori deri në shtator 1948, të gjithë u kthyen kundër PKJ dhe të gjithë ishin në konkurrencë që të rreshtoheshin përkrah BS. Bënin autokritikë se “jugosllavët urdhëronin e ne zbatonim”, se “po të mos kishim marrë letrat e Partisë Bolshevike, jugosllavët do të kishin mbërrit të bënin ç’ të donin”¹³³.

Por lufta që Kremli i kishte shpallur Jugosllavisë synonte shumë më larg. Jugosllavët kishin përkrahësit e tyre kudo në vendet e bllokut. Çdo përkrahje që ata mund t’i jepnin Titos rrezikonte kompaktësimin e bllokut nën diktatin sovjetik. Duhej të shënoheshin përkrahësit, të dënoheshin ata dhe akoma më tej, të bëheshin shembuj për të tjerët. Kjo lojë u hap me Shqipërinë, ku udhëheqja komuniste ishte relativisht e re, më e kapura nga udhëheqja e PKJ, me reagim më të fortë se të gjitha partitë e tjera ndaj PKJ, jo anëtare e Kominformit dhe me kushte skajshmërisht të vështira ndërkombëtare. Qysh më parë sovjetikët ishin të informuar nga këshilltarët e tyre në Shqipëri, nga ambasadori Çuvahin, por edhe nga vetë jugosllavët, për rivalitetet dhe armiqësitë në Byronë Politike të PKSh. Por ajo kthesë e përgjithshme që kishte ndodhur në udhëheqjen shqiptare pas letrave të KQ PKBS dhe pas Rezolucionit të Kominformit, ua kishte bërë sovjetikëve të vështirë shënimin e “mikut” të Titos e “armikut” të Stalinit. Mendojmë se kjo dilemë duhet të ketë marrë fund në fundin e gushtit 1948, kur Tuk Jakova së bashku me Nesti Kerenxhin vajtën në Moskë për probleme ekonomike, por kishin takuar edhe Petrovin, një nga zyrtarët kryesorë për Ballkanin në PK të BS. Krahas dy detyrave të precizuara në dokumentet e kohës për “izolimimin e PKJ nga lëvizja komuniste botërore”, si dhe “izolimimin e udhëheqjes nga PKJ”,¹³⁴ Petrovi duhej ta ketë instruktuar T. Jakovën edhe për veprimet konkrete që do të ndërmerreshin në Shqipëri. Në këtë moment, sovjetikët duhej ta kishin shënuar përfundimisht E. Hoxhën si të preferuarin e tyre, kurse Koçi Xoxen, si fajtorin, mbi të cilin do të binin rrufetë.

¹³¹ *Arhiv Predsednika Republike* (Arhiv Josipa Broza Tita), KMJ. I-3-b/38. Letra e firmosur nga E. Hoxha dhe K. Xoxe dërguar J. B. Titos më 23 maj 1948.

¹³² *AQSh/AP*, viti 1948, dos. 93. Letra e Tretë e KQ PKBS dërguar KQ PKJ u diskutua në Byronë politike të PKSh më 25 maj 1948.

¹³³ *Po aty*, dos. 103. Mbledhje e Byrosë Politike, më 15 qershor 1948.

¹³⁴ *Po aty*, dos. 112. Tuk Jakova, ish ambasador i Shqipërisë në Beograd (1947-1948), anëtar i Byrosë Politike të PKSh, raporton për vizitën e tij në Moskë, në mbledhjen e Byrosë, më 1 shtator 1948.

Në plenumin e XI të KQ PKSh, më 13-24 shtator 1948, i cili rishikoi gjithë veprimtarinë e PKSh që nga 1944.¹³⁵, E. Hoxha ngriti tonin e zërit, bëri diferencime kurajoze mes shokësh, inicioi goditjet e para ndaj atyre që dikur e kishin kritikuar, pohoi me mburrje dhe vendosmëri se “Sekretari Politik i Partisë sonë e ka luajtur rolin e tij si udhëheqës dhe drejtues i partisë dhe e ka bërë detyrën e tij duke drejtuar lëvizjen dhe partinë në rrugë të drejtë”¹³⁶ dhe ndërkohë vuri alarmin për Sigurimin e Shtetit që ishte vënë mbi Partinë. Ai hodhi kështu një hap më tej kundër ish bashkëpunëtorit të tij të afërt Koçi Xoxe, i cili ishte në të njëjtën kohë Ministër i Brendshëm dhe sekretar organizativ i PKSh për kuadrot. E Hoxha kishte prekur në këtë mënyrë një pikë nevalgjike shumë të ndjeshme për gjithë popullin shqiptar. Në atë kohë përmbyjsjesh të mëdha politike, Sigurimi i Shtetit ishte arma më e fuqishme e PKSh për konsolidimin e pushtetit komunist, “syri dhe veshi i Partisë”. Me metoda të frikshme dhe të dhunshme, ai kishte vënë nën kontroll të gjithë jetën e brendshme të vendit. Në mbledhjet e organizuara për të denoncuar organet e Sigurimit të Shtetit, anëtarë të Partisë dhe qytetarë të thjeshtë sollën shembuj të shumtë të abuzimeve të organeve të Sigurimit të Shtetit, siç ishte çarmatimi i banorëve të zonave të veriut me dhunë fizike dhe vrasje, dërgimi i vajzave në aksione me forcë, torturat çnjerëzore të të arrestuarve dhe të burgosurve, survejimet dhe pushkatimet e paligjshme të qytetarëve të pafajshëm etj.¹³⁷

Në Kongresin I të PKSh, që zhvilloi punimet më 8-22 nëntor 1948, pjesëmarrja e delegatëve ishte e censuruar¹³⁸ dhe po ashtu edhe diskutimet e

¹³⁵ *Po aty*, dos. 4. Në Plenumin e XI të PKSh, u dënua ndërhyrja jugosllave në punët e brendshme të PKSh dhe të Shqipërisë që nga plenumi II KQ PKSh, në Berat (tetor 1944); u pohua se Plenumi i VIII i KQ PKSh (shkurt-mars) ishte bërë mbi një platformë antimarksiste dhe antisovjetike; ishte goditur E. Hoxha si pengesa kryesore për nënshtrimin e plotë të vendit; partia ishte gjysmë-ilegale dhe duhej të bëhej legale; K. Xoxe dhe Pandi Kristo kishin bërë punë grupazhi dhe mbanin përgjegjësi për gjendjen; letrat e Partisë Bolshevike kishin qenë shpëtimtare etj. Plenumi rehabilitoi Nako Spirun si “viktimë e intrigave jugosllave” dhe menjëherë pas plenumit u bë me ceremoni rivarrimi i eshtrave të tij, së bashku me ato të tre figurave të tjera të rinisë komuniste shqiptare”; shkarkoi K. Xoxen si sekretar i KQ PKSh dhe në vend të tij zgjodhi Tuk Jakovën; përjashtoi Pandi Kriston nga Byroja Politike e PKSh. Pas Plenumit, Mehmet Shehu u rikthye në postin e shefit të Shtatmadhorisë së Ushtrisë shqiptare. Më 29 tetor, me largimin e K. Xoxes nga ministër i Brendshëm dhe emërimin e tij si ministër i Industrisë, M. Shehu u emërua ministër i Brendshëm.

¹³⁶ *Po aty*, dos. 49, fl.13.

¹³⁷ *Po aty*, dos. 76; dos. 90; 70. Strukturë.

¹³⁸ Zgjedhjet e delegatëve për në Kongresin I të PKSh u ripërsëritën, pasi në to ishin futur simpatizantë të K. Xoxes, i cili megjithëse ishte larguar nga posti i sekretarit organizativ, vazhdonte të qëndronte ministër i Industrisë dhe të kishte përkrahësit e tij në strukturat e partisë dhe të shtetit.

tyre. Emri i BS dhe i Stalinit përdoreshin vend e pavend. Fryma e tij antijugosllave ishte marramendëse. Ambasadori sovjetik që ishte prezent në sallë do ta përcaktojë atmosferën që zotëronte në kongres si një “tensionim në formë llave”, “psikozë demaskuese në radhët e partisë ndaj grupit të K. Xoxes e P. Kristos¹³⁹. Në kongres, K. Xoxe u bë përgjegjës për të gjitha dobësitë, gabimet, mosrealizimet në veprimtarinë e PKSh dhe të shtetit shqiptar. Ai dhe Pandi Kristo u akuzuan si “mbrojtës dhe zbatues të platformës trockiste të PKJ në Byronë Politike”, që kishin “izoluar E. Hoxhën”, që “përgatitën terrenin për likuidimin e N. Spirut dhe shokëve të tjerë të afërt të E. Hoxhës”, se ishin “përgjegjës për mungesën e unitetit në udhëheqjen e PKSh”, se disiplina e ndërgjegjshme mungonte në PKSh për shkak të “frymës trockiste që futi K. Xoxe”, se K. Xoxe e Pandi Kristo “përdorën të drejtën e fjalës në kongres për të sulmuar vijën e drejtë të Partisë” etj. Për të gjitha këto, kongresi përjashtoi K. Xoxen dhe Pandi Kriston nga PKSh,¹⁴⁰ kurse më 2 dhjetor ata u arrestuan.¹⁴¹ Më 25 prill 1949, me vendim të Byrosë Politike u krijua një Gjyq Special. Prokuror i çështjes u caktua një nga sekretarët e PPSH, Bedri Spahiu. Byroja Politike vendosi që gjyqi të bëhej në Tiranë, me dyer të mbyllura. Në mbarim të gjyqit do të lëshohej një komunikatë nga organet e drejtësisë.¹⁴² Duke e konsideruar një gjyq të mirëfilltë politik, E. Hoxha u tregua i kujdesshëm që të konsultohet me sovjetikët, madje dhe me vetë Stalinin. Më vonë, E. Hoxha takoi Çuvahinin, të cilit i tha se KQ po merrej me përgatitjen e fjalës së mbylljes së prokurorit Bedri Spahiu, pasi “procesi mbi grupin e K. Xoxes është një proces kundër klikës nacionaliste trockiste të Titos”.¹⁴³

Pikërisht kështu e kuptonin edhe në Beograd këtë proces. Gazetat jugosllave “Borba”, “Politika”, “Glas” e paraqitën atë si “një proces me dyer të mbyllura dhe se nuk është lejuar asnjë gazetar i huaj, veçse Agjencia Telegrafike Shqiptare, e cila jep lajme sipas dëshirës dhe interesit të Informbyrosë”. Gazeta e KQ PKJ, “Borba”, më 21 maj 1949, botonte artikullin me titull: “Informbyroistët përgatisin vrasjen e të pandehurve pa faj në Tiranë”.

¹³⁹ *Vostoçnaja Evropa v Dokumentah ...*, dok. 304.

¹⁴⁰ *AQSh/AP*, viti 1948, dos. 30. Rezoluta e Kongresit I PKSh. Kongresi mori dhe vendime të tjera: Shtimi i dashurisë për BS, kokën e kampit socialist; ndryshoi emrin e PKSh në Partia e Punës e Shqipërisë PPSH; aprovoi statutin e partisë; të shkruhej historia e PPSH; të verifikonte biografitë e kandidatëve dhe anëtarëve të PPSH; të rishikonte të gjithë legjislacionin ekzistues; të forcohej lufta e klasave.

¹⁴¹ *Po aty*, dos. 51.

¹⁴² *Po aty*, viti 1949, dos. 29.

¹⁴³ *Vostoçnaja Evropa v Dokumentah ...*, dok. 36. Më 10 qershor 1949, prokurori Bedri Spahiu dha prentencën me vdekje për K. Xoxen dhe të nesërmen ai u pushkatua. Kurse Pandi Kristo u dënua me 20 vjet heqje lirie me punë të detyruar; Vaskë Koleci, 10 vjet heqje lirie me punë të detyruar, Vango Mitrojorgji, 5 vjet heqje lirie me punë të detyruar.

Sipas artikullit “të gjithë udhëheqësit shqiptarë kanë mbajtur kontakte me udhëheqjen jugosllave dhe kanë njohur ndihmën e pakursyer e vëllazërore të Jugosllavisë për popullin shqiptar” dhe se qëllimi i qeverisë së Tiranës është “që procesin ta shfrytëzojë për sulme kundra Jugosllavisë”.¹⁴⁴ Më vonë, kur në shtator 1949, në Budapest do të hapej gjyqi i Laslo Rajkut, jugosllavët do ta quanin procesin e K. Xoxes “paraloja e procesit të Rajkut” dhe do të shtronin pyetjen: “Po tani kush e ka radhën?”¹⁴⁵

Propaganda, që u zhvillua brenda vendit për dënimin e K. Xoxes si agjent i jugosllavëve dhe si përgjegjës për dhunën e ushtruar nga organet e Sigurimit të Shtetit ndaj qytetarëve shqiptarë, ishte bombarduese. Megjithëse dënimi i tij u mirëprit në popull, e vërteta është se pati dhe shumë pëshpëritje.¹⁴⁶ Më vonë, ashtu siç kishte vendosur Kongresi I i PKSh, në emër të thellimit të luftës së klasave, filluan spastrimet në organet e shtetit dhe të partisë për të gjithë mbështetësit e K. Xoxes.

Pas shpalljes së Rezolutës së Kominformit, marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u përkeqësuan. Me nota të ndërsjella të dy qeveritë akuzonin njëra-tjetrën për problemet ekonomike, reparacionet e luftës për Shqipërinë, të cilat kishin mbetur në Jugosllavi, riatdhesimet e shtetasve respektivë, veprimtari agjenturore të legatave të njëra-tjetrës etj. Shqipëria mori pjesë aktive në fushatën për të izoluar udhëheqjen e PKJ në të gjitha organizmat ndërkombëtare, si në Kongresin Botëror të Paqes, në Organizatën e Juristëve Demokratë, në Federatën Demokratike të Grave etj.¹⁴⁷ Deri në nëntor 1949, Shqipëria ishte i vetmi vend i bllokut komunist, i cili nuk e kishte anuluar formalisht Traktatin e Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke me Jugosllavinë. Për udhëheqjen jugosllave kjo dukej “gjë e çuditshme..., një makinacion i llojit të saj”. Madje M. Gjilas do ta trajtonte këtë çështje edhe në OKB, ku do të deklaronte se “Këtë (denoncimin e Traktatit të Miqësisë-A.L.) nuk e bëri vetëm Shqipëria dhe kjo jo për politikë të ndryshme të qeverisë së saj me vendet e

¹⁴⁴ AMPJ, viti 1949, dos. 235. Informacion i ambasadës shqiptare në Beograd.

¹⁴⁵ *Po aty*, dos. 164. Informacion i ambasadës shqiptare në Beograd.

¹⁴⁶ *AQSh/AP*, viti 1949, dos. 394; 350, Strukturë. Në popull pëshpëritej se gjyqi i K. Xoxes nuk është i drejtë që po bëhet me dyer të mbyllura. Gjyqi bëhet vetëm sa për historinë; Koçi nuk ka qenë vetëm. Për veprimtarinë kriminale dhe torturat e paligjshme që ka bërë Koçi kanë pas dijeni edhe të tjerët. Si është e mundur që KQ i PKSh të mos i dijë këto gjëra, të cilat edhe populli i kishte dëgjuar dhe se disa të burgosur në procese të ndryshme e kishin pohuar këtë. Për të “sqaruar” popullin u dërguan në mbledhje njerëz të partisë e të pushtetit. Përgjigjet e tyre ishin standarde, si p.sh “po të bëhej i çelur ky gjyq, armiku do të kishte mundur të na kuptonte shumë gjëra. Të gjitha gjërat interesante që duhet të dihen nga populli i kanë thënë gazetatat... Kështu që dhe gjyqi në vetvete ka pasur karakter të hapur”.

¹⁴⁷ AMPJ, viti 1949, dos. 16.

tjera të lindjes, por për gjithfarë planesh, ku ajo loz rolin e caktuar”.¹⁴⁸ Ajo që nuk thuhej por nënkuptohej ishte dyshimi se Shqipëria mund të përdorej si pretekst dhe si një portë e hapur për të sulmuar Jugosllavinë nga BS dhe vendet e tjera të Lindjes. Në fakt, nuk ka asnjë të dhënë për “makinacione” ose për ndonjë lojë të shqiptarëve. Arsyeja më e mundshme është një llogari e thjeshtë e qeverisë së Tiranës për interesat e saj të sigurisë. Në rrethanat e tensionuara me fqinjën jugor, Greqinë, prishja “*de jure*” e paktit të miqësisë me fqinjën tjetër të veriut, do të ishte një hap që mund të sillte të papritura. Por atë që nuk e kishte bërë Tirana, e bëri vetë Beogradi. Më 2 nëntor ambasadori jugosllav në Tiranë i dorëzoi zëvendësministrit shqiptar të Punëve të Jashtme një notë të qeverisë së tij, ku kërkohej që qeveria e RP të Shqipërisë të kthehej në politikën e miqësisë dhe të bashkëpunimit me RFPJ dhe të përmbushte angazhimet që kishte marrë në traktatin e miqësisë midis dy vendeve.¹⁴⁹ Qeveria shqiptare formuloi një përgjigje kundërshtuese, por nuk u arrit të dërgohej, pasi më 12 nëntor qeveria jugosllave e denoncoi traktatin me Shqipërinë. Në notën zyrtare të Beogradit thuhej se qeveria shqiptare kishte marrë role provokuese kundër pavarësisë dhe integritetit të RFPJ dhe se ajo ishte vënë në shërbim të politikës armiqësore të BS ndaj Jugosllavisë dhe për këto arsye ajo e quante veten të lirë nga detyrimet që rridhnin prej traktatit të miqësisë të 9 korrikut 1946.¹⁵⁰

Jehona e këtij veprimi nuk bëri asnjë përshtypje në popullin shqiptar. Në vitet e mëvonshme vijuan veprimet diversioniste e provokacionet e Jugosllavisë ndaj Shqipërisë dhe anasjelltas, organizimi i emigracionit shqiptar në Jugosllavi dhe i emigracionit jugosllav në Shqipëri, duke e ngritur problemin deri në OKB, në nëntor të vitit 1951.¹⁵¹ Në vitet 1950-1953 pati një ndërprerje të marrëdhënieve diplomatike shqiptaro-jugosllave¹⁵². Gjatë kësaj kohe, me urdhër të KQ PPSH, u hoqën nga qarkullimi, u dërguan për karton dhe u dogjën të gjithë librat ku flitej pozitivisht për Jugosllavinë, fjalimet e K. Xoxes dhe fjalimet e përkthyer të udhëheqësve jugosllavë etj.

Pas vdekjes së Stalinit, 1953, në BS dhe në Bllokun komunist filloi kursi i ri i destalinizimit, ku afrimi me Jugosllavinë ishte një nga drejtimet kryesore të

¹⁴⁸ *Po aty*, dos. 235. Cituar sipas informacioneve të ardhura nga legata shqiptare në Beograd.

¹⁴⁹ *Po aty*, dos. 191, Notë nr. 348, dt. 31. 10. 1949, e qeverisë së RFPJ për qeverinë shqiptare.

¹⁵⁰ *Po aty*, dos. 191, Notë nr. 420458, dt. 12.11.1949, e qeverisë së RFPJ për qeverinë shqiptare.

¹⁵¹ *Po aty*, viti 1951, dos. 230.

¹⁵² Më 27 maj 1950 personeli i ambasadës jugosllave u largua nga Tirana, ndërsa më 18 nëntor 1950 personeli i legatës shqiptare u largua nga Beogradi. Rivendosja e marrëdhënieve u bë me iniciativën e qeverisë shqiptare. Qeveria jugosllave shfaqti miratimin e vet të menjëhershëm më 21 dhjetor 1953.

tij. Udhëheqësit shqiptarë e pritën me pezmatim dhe plot dyshime afrimin e N. Hrushovit me Titon dhe PKJ. Kur më 23 maj 1955, KQ i PPSH njoftohej për takimin Hrushov-Tito dhe për Komunikatën për anulimin e Rezolutës së Informbyrosë të nëntorit 1949, E. Hoxha i revoltuar, mbledhi urgjentisht Byronë Politike. Të nesërmen ai i dorëzoi një letër ambasadorit sovjetik në Tiranë, Leviçkin, në të cilën deklarohet qëndrimi unanim i Byrosë Politike të PPSH se përmbajtja principiale e rezolucioneve të Informbyrosë kishte qenë “plotësisht e drejtë” dhe se duhej të organizohej “një mbledhje e partive, anëtare të Informbyrosë, ku të merrte pjesë edhe PPSH... dhe të merrej një vendim i përbashkët për çështjen”.¹⁵³ Por vetëm një ditë më pas, në një mbledhje tjetër të Byrosë Politike, të gjithë anëtarët u tërhoqën nga qëndrimi i mësipërm, nën pretekstin se lidhur me çështjen jugosllave ata nuk kishin “parë interesin i përgjithshëm dhe se ... ishte vënë në dyshim vija e udhëheqjes së PKBS.”¹⁵⁴ Pas mbledhjes iu dërguan dy letra KQ PKBS, ku bëhej autokritikë për qëndrimin e mbajtur në letrën e 25 majit 1955.

Rehabilitimi i plotë i Jugosllavisë, ashtu siç rekomandonte Hrushovi, do të thoshte që E. Hoxha jo vetëm të gëlltiste, por dhe të bëhej përgjegjës përballë opinionit ndërkombëtar, të kampit komunist dhe të popullit të vet për çka kishte ndodhur në marrëdhëniet shqiptare-jugosllave. Kjo do të ishte me pasoja për pozitën e E. Hoxhës. Atëherë ky i fundit luajti politikisht me retushe të përmbajtura, ndonjëherë edhe spektakolare, me efekt në opinion e në Parti, por nuk preku çështjet që i rrezikonin pushtetin e tij. Ai i dha porosi Ministrisë së Jashtme “të evitonte çdo fërkim me funksionarët e Legatës jugosllave në Tiranë”; Ministrisë së Brendshme “të evitonte çdo incident në kufi”; Drejtorisë së Propagandës “të ndiqen artikujt e “Pravdës” dhe pastaj të veprohet ... Nuk kemi besim te jugosllavët, por edhe nuk do t’u themi që ata janë armiq dhe të lidhur me imperializmin”. KQ u dërgonte institucioneve kryesore shkencore e kulturore qarkore për “të hequr nga qarkullimi të gjitha botimet (libra, ilustracione, pllakada), që flasin kundër regjimit të sotëm në Jugosllavi”¹⁵⁵ Gjithashtu u mbyll gazeta e emigrantëve informbyroistë “Za Slobodu” dhe u shpërnda organizata e tyre në Shqipëri etj. Në Kongresin e III të PPSH në maj 1956, E. Hoxha pranoi se “ishte mashtruar” ndaj Jugosllavisë, por nuk pohoi se K. Xoxe nuk ishte agjent i Jugosllavisë. Ajo që E. Hoxha pohoi ishte se problemi i K. Xoxes ishte një çështje e brendshme e PPSH dhe “nuk kishte lidhje me jugosllavët”, por megjithatë ai pohonte se K. Xoxe “mori dënimin e

¹⁵³ *AQSh/AP*, viti 1955, dos. 10. Marrëdhëniet e PPSH me PKBS.

¹⁵⁴ *Po aty*.

¹⁵⁵ *Po aty*, dos. 164.

merituar”, dhe se akuzat “fashistë”, “antimarksistë” etj. për udhëheqësit jugosllavë ishin “të padrejta”.¹⁵⁶

Në shkurt 1956, E. Hoxha i komunikoi Byrosë Politike të PPSH se në një takim në Moskë ndërmjet përfaqësuesve të partive anëtare të Kominformit dhe të ftuarve nga partitë komuniste të Kinës, Koresë, Mongolisë, Gjermanisë Lindore dhe Shqipërisë, ishte vendosur shpërndarja e Kominformit. Në Byronë Politike të PPSH “të gjithë anëtarët ishin dakord”.

S u m m a r y

ALBANIA AND COMINFORM

The PKSH was not a member of the Cominform. It remains unclear why the Yugoslav proposal to include it at the founding meeting of the communist organization was rejected by the Soviets. Albania was never invited to Cominform meetings, not even in the role of observer. As a matter of fact, the PKSH leadership expected to be invited to the June 1948 meeting, if only in recognition of their support of Stalin’s letters of March and April 1948. From 19 until 23 June 1948, the Cominform meeting focused solely on the “situation within the Yugoslav Communist Party.” The meeting produced a resolution pronouncing the Yugoslav response, among other things, as a confirmation of Belgrade’s self-exclusion from the family of communist parties (meaning also from the Cominform). That statement was published on 29 June 1948 in all the newspapers of the member parties of the Cominform. On the same day, party plenums were hastily convened in Belgrade and Tirana. The paper explains the sudden but intense Albanian fervor in denouncing the Yugoslav leadership, including the cancellation of all treaties, agreements, and accords. As it turns out, the “undying friendship bound by blood” between the Yugoslav and Albanian peoples was hardly built on principles of equality and a shared sense of partnership. Rather, it was based on a dynamic of dependency. As a result, these unequal relations bred considerable discontent and, even more importantly, a situation in which growing political, national, and power interests demanded more room and security than the relationship with Belgrade could provide. Numerous available archival sources, and especially Albanian ones, allow us to revisit these complex relations, assess the nuances, and draw conclusions on what has already been known and what is less known.

¹⁵⁶ Enver Hoxha, *Raporti i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë në Kongresin III të Partisë*, 25 maj 1956, Tiranë, f. 36-37.